



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE NAUKU I TEHNOLOGIJU
MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOG

 **INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS**

STANDARDET PËR SHKOLLAT MIKE PËR FËMIJË

Prishtinë, 2014

Botues:

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Për botuesin:

Nezir Çoçaj

Redaktorë:

Hajrije Devetaku-Gojani

Selim Mehmeti

Miranda Kasneci

Lektor:

Bekim Morina

Përgatitja teknike:

Shtypshkronja – Printing House “Blendi”

Ky publikim është përgatitur nga Instituti Pedagogjik i Kosovës, me mbështetjen e UNICEF-it, Zyra në Kosovë.

pristina@unicef.org; www.unicef.org/kosovo

Janar, 2014

PËRMBAJTJA

Shkurtesat	8
Parathënie	9
I. Hyrje	11
1.1. Sfondi/parathënia	12
1.2. Historiku i shkollave mike për fëmijë në Kosovë	12
II. Hartimi i standardeve për shkollat mike për fëmijë në Kosovë	15
2.1. Çfarë janë standardet për shkollat mike për fëmijë dhe cili është funksioni i tyre	15
2.2. Qëllimi i standardeve për shkollat mike për fëmijë	17
2.3. Parimet në të cilat janë mbështetur standardet për shkollat mike për fëmijë	17
III. Struktura dhe organizimi i standardeve për shkollat mike për fëmijë	21
3.1. Si definohen konceptet kryesore të standardeve për shkollat mike për fëmijë?.....	21
3.2. Cilat janë dimensionet e standardeve për shkollat mike për fëmijë në Kosovë?	22
3.3. Si ndërlidhet koncepti i shkollave mike për fëmijë me qasjen gjithëpërfshirëse në arsim?	24
3.4. Çfarë përmbajnë përkufizimet e secilit dimension të standardeve të SHMF në Kosovë?.....	24
3.5. Cilat janë standardet e përcaktuara?	27
3.6. Treguesit e standardeve të shkollave mike për fëmijë dhe organizimi i tyre	29
3.7. Organizimi i treguesve të standardeve në komponente – fusha zhvillimore të shkollës	31
3.7.1. Gjithëpërfshirja	31
3.7.2. Efektiviteti në mësimdhënie dhe nxënie	36
3.7.3. Shëndeti, mjedisi dhe siguria	41
3.7.4. Pjesëmarrja demokratike.....	45
3.7.5. Barazia gjinore	50
3.7.6. Diversiteti kulturor.....	53
3.8. Si mund të shfrytëzohen standardet e SHMF për të vetëvlerësuar performancën e punës së shkollës?	55
Bibliografia	57
Kontribuuesit në hartimin e dokumentit	59

SHKURTESAT

DKA	Drejtori Komunale e Arsimit
DUDNJ	Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
EPRMB	Ekipi për Parandalimin dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit
IA	Inspektorati i Arsimit
IPK	Instituti Pedagogjik i Kosovës
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
KKK	Korniza e Kurrikulës Kombëtare
KDSH	Këshilli Drejtues i Shkollës
MASHT	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OJQ	Organizata Jo Qeveritare
PIA	Plani Individual i Arsimit
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë
SHMF	Shkollë Mike për Fëmijë
SMIA	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim
TIK	Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë
UNICEF	Fondi për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

Parathënie

Të dashur nxënës, mësimdhënës, prindër dhe drejtorë të shkollave,

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, me Kornizën e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar në Kosovë dhe me dokumente të tjera strategjike ka përcaktuar më shumë autonomi për shkollën. Me këtë, shkollës i besohet dhe i mundësohet që të ndërtojë profilin e vet në interesin më të mirë të nxënësve të saj dhe të lokalitetit në të cilin vepron. Autonomia për shkollën kërkon përfshirjen aktive të komunitetit të shkollës në sigurimin e cilësisë në shkollë dhe zhvillimin e saj drejt shkollës gjithëpërfshirëse.

*Në përkrahje të shkollave në sigurimin e cilësisë në shkollë, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë mori iniciativën për përgatitjen e dokumentit: **Standardet për Shkollat Mike për Fëmijë**. Përgatitja e këtij dokumenti, me rëndësi të veçantë për shkollën, u realizua nga Instituti Pedagogjik i Kosovës, me një grup të përbashkët të ekspertëve nga MASHT-i dhe IPK-ja dhe me përkrahjen e UNICEF-it. Dokumenti është konceptuar si një mjet ndihmës për shkollën dhe ekipet e saj që merren me vlerësimin e brendshëm të shkollës, me qëllim të përmirësimit dhe avancimit të cilësisë së punës në shkollë.*

*Dokumentit **Standardet për Shkollat Mike për Fëmijë** përmban standardet dhe treguesit arsimorë të matshëm për gjashtë dimensione të rëndësishme për punën e shkollës, që synojnë përmirësimin dhe avancimin e cilësisë së punës së shkollës në komponentën e (i) menaxhimit dhe qeverisjes, (ii) kapaciteteve të shkollës, dhe (iii) kurrikulës e procesit mësimor.*

Përmes përfshirjes së treguesve arsimorë të këtij dokumenti në instrumentet e vlerësimit të brendshëm të shkollës dhe zbatimit të tyre gjatë procesit të vlerësimit pritet që të zhvillohet një proces i analizës përmbajtjesore të gjendjes në shkollë, i cili do të sigurojë të dhëna reale për pikat e forta dhe pikat e dobëta të shkollës, nevojat dhe mundësitë që ka shkolla për të përmirësuar dhe avancuar cilësinë e punës në shkollë dhe për ta bërë atë Shkollë Mike për Fëmijë.

Procesi i vlerësimit të brendshëm të shkollës, në të gjitha komponentët e saj, kërkon kohë, përpjekje dhe angazhim profesional, punë ekipore dhe përfshirje aktive të të gjithë komunitetit të shkollës në aktivitetet vjetore që ju do t'i zhvilloni çdo vit në vlerësimin e brendshëm të shkollës, në planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve për përmirësim dhe avancim të cilësisë së punës në shkollë.

Ne ju inkurajojmë që ta filloni procesin e vlerësimit të brendshëm të shkollës.

Suksese!

Prof. Dr. Ramë Buja
Ministër i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë

I. HYRJE

Krahas ndryshimeve të vazhdueshme në fushën e arsimit parauniversitar dhe zhvillimit të dokumenteve të ndryshme strategjike, ligjeve, programeve dhe projekteve të rëndësishme për arsimin, dokumenti i Standardeve për Shkollat Mike për Fëmijë është një dokument, i cili do të ndihmojë dhe lehtësojë zbatimin praktik të kërkesave të arsimit në funksion të interesimeve, nevojave dhe perspektivës së fëmijëve.

Filozofia e shkollave mike për fëmijë është pjesë e reformimit të arsimit dhe përmirësimit të cilësisë së tij. Kjo qasje krijon mundësinë e vlerësimit të punës së shkollës dhe politikave e programeve të arsimit që lidhen me dimensionet e standardeve të shkollave mike për fëmijë, rezultateve të arritura, por njëkohësisht edhe të asaj që mbetet për t'u ndryshuar dhe përmirësuar në proces, si rezultat i vlerësimit dhe vetëvlerësimit.

Nevoja për hartimin e standardeve për shkollat mike për fëmijë doli si rezultat i ndryshimeve në fushën e kurrikulës, në përkrahje të synimit të krijimit të shkollave efektive, të shëndetshme, mbrojtëse dhe gjithëpërfshirëse, me një pjesëmarrje aktive të prindërve dhe të komunitetit, të cilën e ka iniciuar UNICEF-i. Standardet e Shkollave Mike për Fëmijë përfaqësojnë konceptin e cilësisë së arsimit, i cili synon më shumë se cilësinë e mësimdhënies dhe nivelin e arritshmërisë së fëmijës. Mbështetur në konceptin e shkollave mike për fëmijë, cilësia e arsimit merr parasysh këto aspekte, si në vijim:

- *Sa është duke u zbatuar mësimdhënia dhe nxënia me nxënësin/nxënësen në qendër?*
- *Sa nxitet pjesëmarrja e fëmijëve në jetën shkollë/menaxhimin e klasës dhe shkollës?*
- *Sa respektohen dhe mbrohen të drejtat e fëmijëve nga shkolla dhe mësimdhënësit?*
- *Sa janë të përgatitur nxënësit/nxënëset për të vazhduar shkollimin?*
- *Sa është përgatitur shkolla dhe mësimdhënësit për t'i pranuar nxënësit/nxënëset dhe për t'u plotësuar nevojat dhe të drejtat e tyre?*
- *Sa është arritur që të sigurohet shëndeti dhe mirëqenia e nxënësit/nxënëses për të vijuar shkollimin?*
- *Sa është investuar në angazhimin dhe mobilizimin e burimeve të mundshme për krijimin e klasave stimuluese që përkrahin të mësuarit aktiv për të gjithë nxënësit/nxënëset?*
- *Sa janë shkollat të pajisura me hapësira, pajisje dhe shërbime për t'i plotësuar nevojat e të gjithë nxënësve?*
- *Në ç'masë shkolla lufton diskriminimin gjinor, etnik, social etj?*
- *Në ç'masë shkolla vë të gjitha burimet e saj në funksion të arsimit të nxënësve etj?*

1.1. Sfondi/parathënia

Koncepti i Shkollave Mike për Fëmijë (SHMF) mbështetet në Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF) dhe paraqet qasje gjithëpërfshirëse që ndërlidh aspektet e reformës në arsim dhe e cila e vendos fëmijën në qendër të vëmendjes në të gjitha aktivitetet që organizohen dhe zbatohen në shkollë.

Shkollë mike për fëmijë është shkolla që ofron arsim cilësor për të gjithë fëmijët, duke i adresuar të gjitha çështjet, të cilat ndikojnë në mirëqenien, të drejtat dhe mjedisin miqësor gjatë të mësuarit për secilin fëmijë.

Çdo gjë që organizohet dhe zhvillohet në procesin mësimor është në funksion të mbrojtjes së interesave të fëmijëve. Kjo qasje promovon të drejtën e nxënësit/nxënëses për të zgjedhur, për të komunikuar dhe i lejon ata të mendojnë, të përjetojnë, të eksplorojnë, të bëjnë pyetje dhe të kërkojnë përgjigje. Është parim kryesor që i karakterizon Shkollat Mike për Fëmijë, përmes të cilit bëhen përpjekje të vazhdueshme për plotësimin e kërkesave të secilit fëmijë dhe respektin për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Në përgjithësi, parimet dhe dimensionet e Shkollave Mike për Fëmijë mund të gjenden në dokumente të ndryshme të Republikës së Kosovës, si në Kushtetutën e Kosovës (të drejtat themelore të arsimit), Ligjin për arsimin fillor (gjithëpërfshirja, efikasiteti), objektivat strategjike të arsimit parauniversitar 2007-2017 (efikasiteti, gjithëpërfshirja, shëndeti), Planin Strategjik të Arsimit 2011-2016 (gjithëpërfshirja, efektiviteti i mësimdhënies dhe nxënies) dhe Kornizën e Kurrikulës Kombëtare 2011 (mësimi me fëmijën në qendër, gjithëpërfshirja, pjesëmarrja) dhe në strategji e dokumente të tjera.

Qasja e Shkollave Mike për Fëmijë (SHMF) në Kosovë përfshin gjashtë dimensione përmes së cilave integrohen komponentë të veçantë të dokumenteve të theksuara: (1) Arsimi gjithëpërfshirës; (2) Efektiviteti i mësimdhënies dhe nxënies; (3) Shëndeti, mjedisi dhe siguria; (4) Pjesëmarrja demokratike; (5) Barazia gjinore; (6) Diversiteti kulturor. Gjashtë dimensionet, nëse merren së bashku, sigurojnë një pasqyrë të arsimit cilësor për të gjithë fëmijët dhe ofrojnë një kornizë për veprim, në kuadër të së cilës mund të vendosen dhe të arrihen standardet e shkollave mike për fëmijë.

1.2. Historiku i Shkollave Mike për Fëmijë në Kosovë

Zbatimi i pilot-projektit të Shkollave Mike për Fëmijë është dizajnuar me qëllim të paraqitjes së risive, ndryshimeve në sistemin e arsimit. Që një shkollë të konsiderohet si shkollë mike për fëmijë duhet t'i përmbushë disa kritere, të cilat do të mundësojnë realizimin kuptimplotë të parimeve kryesore që dalin nga koncepti i Shkollave Mike për Fëmijë.

Zbatimi dhe përkrahja e projektit është bërë në tri faza. Gjatë fazës fillestare të projektit (2000-2002) janë zgjedhur 35 shkolla pilot dhe janë ndërmarrë këto intervenime:

- ✓ Është bërë pajisja e shkollave me mjete pune, si me kompjuterë, laboratorë shkencorë, makina fotokopjuese, TV / video, pajisje sportive;
- ✓ Është riparuar sistemi i ujësjellësit/ kanalizimit;
- ✓ Është bërë trajnimi i drejtorëve të shkollave, mësimeve, fëmijëve dhe komunitetit;
- ✓ Është bërë përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Në vitin 2003, 48 shkolla të tjera iu shtuan nismës në mënyrë që të përhapet koncepti i Shkollave Mike për Fëmijë në tërë Kosovën. OJQ-të (partnerët zbatues, si: World Vision, CRS, Qendra për Arsim e Kosovës, 'Care International', Forumi i Gruas Kosovare, EducAid, etj.) u përqendruan dhe zbatuan dimensione të ndryshme në shkolla të ndryshme, për shembull, CRS punoi rreth ngritjes së kapaciteteve të këshillave të prindërve, World Vision punoi për paqen dhe zgjidhjen e konflikteve, EducAid në arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta etj.

Në vitin 2006, puna e lidhur me shkollat mike përfundoi, por konceptet që përbëjnë thelbin e shkollave mike për fëmijë nuk përfunduan. Përderisa shumica e organizatave partnere u mbyllën, ishte ndërtuar një kapacitet në nivelin vendas, të cilët vazhduan zbatimin e risive, siç janë shkollat dhe klasat gjithëpërfshirëse, dhe qasja me fëmijën në qendër. Rreth 160 shkolla prej atëherë vazhdojnë punën duke u mbështetur në parimet e shkollave mike për fëmijë.

Ky projekt ka pasur për qëllim promovimin e qasjes së punës me fëmijën në qendër. Insiston në kujdesin e vazhduar ndaj fëmijëve, ndjeshmërinë ndaj gjinisë, gjithëpërfshirjen në sistemin e arsimit, përfshirjen e komunitetit, si dhe në qasjet e shëndosha dhe mbrojtëse gjatë shkollimit si dhe jashtë shkollës. Këta komponentë kanë për synim nxitjen dhe shtimin e efikasitetit në mësim dhe arritjen e aftësive për jetë të fëmijëve.

Për UNICEF-in shkollat mike për fëmijë karakterizohen si vende potenciale për përmbushjen e një sërë të drejtash të fëmijëve. Gjatë zbatimit të projektit të shkollave mike për fëmijë janë arritur një sërë rezultatesh, të cilat vlerësohen si përvojë me vlerë. Nisma e shkollave mike për fëmijë ka krijuar themelet për qasje të drejtë ndaj decentralizimit dhe pjesëmarrjes aktive në zhvillimin e arsimit. Aktivitetet e projektit kanë ndërtuar kapacitete institucionale dhe udhëheqëse në nivel të shkollës dhe të komunitetit. Janë hulumtuar mundësitë dhe pamundësitë e prezantimit të ndryshimeve dhe nga to janë nxjerrë mësimet e praktika pozitive. Janë bërë tentime të vazhdueshme në procesin e planifikimit dhe menaxhimit të shkollave, nga bartësit e nivelit shkollor dhe vendas. Është bërë përfshirja e fëmijëve me aftësi të ndryshme dhe e fëmijëve me prejardhje të ndryshme shoqërore-ekonomike dhe etnike. Janë praktikuar metodat

ndërvepruese të mësimdhënies, përmes pjesëmarrjes aktive. Mësimdhënësit, prindërit dhe përfaqësuesit e autoriteteve lokale janë informuar për Konventën e të Drejtave të Fëmijëve, kanë planifikuar dhe kanë realizuar aktivitete në nivel të shkollave për t'i demonstruar në praktikë të drejtat e fëmijëve.

Në sajë të këtij projekti dhe bashkëpunimit me Organizatën Botërore për Shëndetësi, u themelua Komiteti ndërministror për shkollat promovuese të shëndetit dhe në fillim të viti 2004 u nënshkrua marrëveshja e mirëkuptimit nga ana e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me qëllim të zhvillimit të politikave për shkollat promovuese të shëndetit.

II. HARTIMI I STANDARDEVE PËR SHKOLLAT MIKE PËR FËMIJË NË KOSOVË

Procesi i zhvillimit të standardeve për shkollat mike për fëmijë në Kosovë mbështetet në aktivitetet paraprake të projektit, si dhe në konceptin e cilësisë së arsimit në Kosovë.

Me marrëveshjen e mirëkuptimit, të nënshkruar në mes të Institutit Pedagogjik të Kosovës, UNICEF-it dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, për zhvillimin e Standardeve ***Shkollat Mike për Fëmijë - një mënyrë për ta përmirësuar cilësinë e arsimit në Kosovë***, Instituti Pedagogjik i Kosovës u emërua si bartës kryesor për të udhëhequr aktivitetet në hartimin e standardeve dhe në bashkërendimin e aktiviteteve mbështetëse për shkollat dhe institucionet e arsimit në zbatimin e këtyre standardeve.

Standardet u hartuan nga një grup hartuesish vendas, në përbërje nga Instituti Pedagogjik i Kosovës, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, mësimdhënës, inspektorë të arsimit, të cilët ndihmuan në hartimin e të gjitha dimensioneve, standardeve, treguesve dhe komponentëve të këtij dokumenti, duke u mbështetur në kriteret e përcaktuara për hartimin e standardeve.

Grupin punues për hartimin e Standardeve për Shkollat Mike për Fëmijë e ndihmuan ekspertët amerikanë, Anne Katz dhe Katherine Ramage¹, posaçërisht në dy punëtoritë e organizuara në Prishtinë. Ndihma e ekspertëve është përqendruar në sjelljen e përvojave në fushën e hartimit të standardeve, në kriteret dhe parimet, të cilat duhet t'i përmbajnë standardet dhe treguesit. Po ashtu, ekspertët kanë ndihmuar edhe në rishikimin e dokumentit të standardeve me dhënien e rekomandimeve, me qëllim të përmirësimit dhe plotësimit të dokumentit.

2.1. Çfarë janë Standardet për Shkollat Mike për Fëmijë dhe cili është funksioni i tyre

Aktualisht, arsimi parauniversitar në Republikën e Kosovës ka standarde në disa fusha të arsimit, ka Kornizën e kurrikulës, të përqendruar në arsim cilësor, në nivelin parauniversitar, si dhe strategji e dokumente të tjera përcjellëse që ndihmojnë funksionalizimin e sistemit të arsimit parauniversitar në Kosovë. Për dallim prej tyre, hartimi i Standardeve për Shkollat Mike për Fëmijë është përqendruar në dimensionet të veçanta për të plotësuar kërkesat dhe nevojat e fëmijëve të Republikës së Kosovës në kontekstin e parimeve të shkollave mike për fëmijë dhe zhvillimeve të reja në arsim, si

¹ Ekspertët të cilat e kanë ndihmuar procesin e hartimit të standardeve për SHMF: Anne Katz & Katherine Ramage, punojnë në kuadër të Miske Witt & Associates Inc, organizatë e njohur me eksperiencë të madhe në fushën e hartimit të standardeve për SHMF.

dhe është parë si një mjet për t'i integruar dhe unifikuar dokumentet ekzistuese të arsimit.

Standardet në këtë dokument janë dhënë në formë të deklaratave të përgjithshme që përcaktojnë atë se çfarë duhet të dinë dhe të jenë në gjendje të bëjnë aktorët në sistemin e arsimit, me theks të veçantë përfaqësuesit në shkollë, për të përmirësuar cilësinë e arsimit. Standardet për Shkollat Mike për Fëmijë janë zhvilluar dhe grupuar në dimensione.

Standardet për Shkollat Mike për Fëmijë² mbështeten në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve dhe sigurojnë cilësi dhe barazi për të gjithë fëmijët në kurrikul, infrastrukturë, shëndetësi, gjithëpërfshirje, të drejta etj.

Koncepti i shkollave mike për fëmijë, siç theksuam edhe më lart, është përhapur në Kosovë prej vitit 2001, mirëpo në mungesë të këtyre standardeve nuk është bërë vlerësimi i efektivitetit të tyre dhe ndikimi në përmirësimin e punës së shkollës. Kjo ishte pikënisja dhe nevoja për t'i hartuar standardet për shkollat mike për fëmijë, të cilat shërbejnë si udhërrëfytes për adresimin e çështjeve të ndryshme, si: të drejtat e fëmijës, shëndetin dhe mirëqenien, barazinë gjinore, gjithëpërfshirjen, pjesëmarrjen aktive në jetën shkollë, në procesin e të mësuarit etj., dhe për ta matur cilësinë dhe vlerësuar punën e shkollës.

Rëndësia e këtij dokumenti qëndron në faktin se, duke u mbështetur në këto standarde, do të mund të bëhet vlerësimi dhe vetëvlerësimin i punës së shkollës, vlerësimi i politikave të arsimit, dokumenteve dhe materialeve të tjera me interes për nxënësin/nxënësen dhe shkollën. Kjo nënkupton se Standardet për Shkollat Mike për Fëmijë shërbejnë për mobilizimin e të gjithë faktorëve relevantë (brenda dhe jashtë shkollës) për të ndihmuar zhvillimin e potencialeve të secilit fëmijë, për t'i identifikuar të arriturat dhe mundësitë për zhvillim të shkollës dhe institucioneve të tjera të arsimit në raport me kërkesat e dokumentit.

Shkollat mike për fëmijë ofrojnë modelin e shkollës në të cilën fëmijët shkojnë me kënaqësi dhe angazhohen në aktivitetet e të mësuarit. Që një shkollë të jetë e tillë, ajo duhet t'i plotësojë disa kritere, që në këtë rast ato janë përcaktuar në kuadër të këtij dokumenti, në secilin dimension. Pastaj çdo standard është zbërthyer në tregues, përmes të cilëve do të mund të matet puna dhe cilësia e shkollës. Me qëllim që të adresohen përgjegjësit kryesorë që ndihmojnë në arritjen e treguesve të standardeve, treguesit janë zbërthyer në tre komponentë kryesorë: (1) Menaxhimi dhe qeverisja, (2) Kapaciteti i shkollës, (3) Kurrikula dhe procesi mësimor.

² Standardet për Shkollat Mike për Fëmijë në disa shtete njihen si standarde të cilësisë në arsim. Ekipi për hartimin e standardeve për SHMF ka vendosur që të ruajë në dokument emërtimin "Shkollë mike për fëmijë".

Ky dokument do t'u shërbejë si pikë referuese Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Drejtorive Komunale të Arsimit, inspektorëve të arsimit, drejtorëve të shkollave, mësuesve, nxënësve, prindërve, organizatave profesionale, hartuesve të kurrikulës dhe të gjithë të tjerëve që janë të përfshirë në procesin e arsimit të fëmijëve.


2.2. Qëllimi i Standardeve për Shkollat Mike për Fëmijë

Standardet për Shkollat Mike për Fëmijë janë hartuar me qëllim të: (1) përfshirjes dhe integritit në një dokument të gjithë komponentëve të treguesve të cilësisë së arsimit që ndikojnë në bërjen e shkollës mike për fëmijë dhe (2) përcaktimit të kërkesave matëse, të cilat ndihmojnë shkollën dhe institucionet e arsimit të rrisin pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve në jetën shkollore dhe në procesin e të mësuarit.

2.3. Parimet në të cilat janë mbështetur Standardet për Shkollat Mike për Fëmijë

a) Parimet e procesit të zhvillimit të Standardeve të Shkollave Mike për Fëmijë

Filozofia e Shkollave Mike për Fëmijë mbështetet në tri parime kryesore: (1) fëmija në qendër, (2) gjithëpërfshirja dhe (3) pjesëmarrja demokratike.



Bazuar në konceptin dhe parimet e Shkollave Mike për Fëmijë, UNICEF (Gjenevë, 2010) ka përcaktuar parimet për hartimin e standardeve në Evropën Qendrore dhe Lindore, siç janë: (1) njohuria, (2) transparenca, (3) përfshirja, (4) përsëritja dhe (5) paanësia.

Njohuria

Për hartimin e Standardeve të Shkollave Mike për Fëmijë janë marrë për bazë dy lloje të njohurive: (1) njohuria për qëndrimet dhe besimet dhe (2) njohuria dhe shkathtësitë teknike.

Në llojin e parë të njohurive – qëndrimet dhe besimi, hartuesit e standardeve, gjatë gjithë procesit të punës, janë orientuar në filozofinë dhe parimet e shkollave mike për fëmijë, përkatësisht i janë përkushtuar qasjes së mbështetur në të drejtat e fëmijës, duke favorizuar dhe vepruar në interesat e fëmijëve pa dallime dhe duke qenë të paanshëm.

Në llojin e dytë të njohurive – njohuri dhe shkathtësi teknike, zhvilluesit e Standardeve të Shkollave Mike për Fëmijë janë mbështetur në dy fusha: (1) ekspertizën e shkollave mike për fëmijë, dhe (2) ekspertizën në standarde. Në fushën e parë, hartuesit e standardeve kanë vendosur që hartimin e standardeve ta bëjnë në dimensione, për të cilat kanë pasur njohuri dhe përvojë në zbatimin e filozofisë dhe parimeve të shkollave mike për fëmijë në Kosovë. Ndërsa, në fushën e dytë, hartuesit e standardeve janë mbështetur në parimet e organizimit të standardeve dhe treguesve dhe janë kujdesur që standardet të jenë në linjë me sistemin e monitorimit dhe vlerësimit të punës së shkollës. Kjo është arritur falë ekspertizës paraprake të hartuesve të Standardeve të Shkollave Mike për Fëmijë në fusha të ndryshme, si në fushën e vlerësimit, hartimit të standardeve, kurrikulave, trajnimit të mësimitdhënësve, monitorimit të shkollës, mësimitdhënies, etj., si dhe në bazë të ekspertizës së marrë nga ekspertët e SSHMF, Anne Katz & Kaherine Ramange (organizata: Miske Witt & Associates Inc), të angazhuara nga Zyra e UNICEF-it në Kosovë – sektori i arsimit.

Transparenca

Hartuesit e Standardeve të Shkollave Mike për Fëmijë, gjatë gjithë procesit të punës, kanë ofruar informata për palët e interesit në të gjitha nivelet e arsimit lidhur me fazat e zhvillimit të standardeve të SHMF, metodologjisë së punës, përfshirjes së dimensioneve, konsultimit të dokumenteve dhe materialeve ekzistuese të lidhura me dimensionet e SSHMF, strukturën e standardeve etj. Informatat janë ofruar përmes takimeve të veçanta me palët që punojnë në arsim dhe për arsimin, punëtorive në nivelin qendror, punëtorive në nivel rajonal, si dhe përmes shpërndarjes së dokumentit në mënyrë elektronike. Mbi bazën e transparencës së ndjekur, dokumenti i SSHMF vazhdimisht është plotësuar, duke përmirësuar cilësinë e tij.

Përfshirja

Standardet e Shkollave Mike për Fëmijë pasqyrojnë një vizion të gjerë të ndryshimeve në arsim. Pasqyrojnë një konsensus në mes të palëve të interesit (prindërve, nxënësve, mësimitdhënësve si dhe pjesëtarëve të komunitetit), të cilët luajnë një rol të rëndësishëm në hartimin e këtyre standardeve në mbështetjen shoqërore, emocionale dhe fizike të

fëmijëve dhe ngritjen akademike. Kjo ka ndodhur përmes seminareve, punëtorive, takimeve të veçanta në faza të ndryshme të hartimit të këtyre standardeve, në të cilat janë përfshirë hartuesit e politikave arsimore, udhëheqësit e shkollave, mësimdhënësit, nxënësit, prindërit, përfaqësues të komunitetit, ekspertë nga universiteti etj.

Përsëritja

Hartimi i standardeve është një proces i kthyeshëm. Kjo do të thotë se hapat e zhvillimit të standardeve përsëriten dhe rezultatet do të përdoren nga faza paraprake për të parë përparimin dhe për planifikimin dhe punën e fazës tjetër. Në fazën e parë të diskutimeve, ato janë rishikuar duke u mbështetur në sugjerimet e dala nga diskutimet me palët e interesit dhe ekspertëve të jashtëm. Në fazën e dytë, ato do të rishikohen duke pasur parasysh rezultatet e studimeve në dimensione të veçanta dhe pilotimit të tyre në shkollat e zgjedhura për mostër.


Paanësia

Hartuesit e Standardeve të Shkollave Mike për Fëmijë kanë qenë përfaqësues të komuniteteve të ndryshme, gjithashtu edhe pjesëmarrësit e përfshirë në takimet për diskutimin e dokumentit në faza të ndryshme të hartimit të tij. Gjithashtu, paanësia është reflektuar edhe në rezultatet e hartimit të standardeve. Hartuesit e standardeve kanë vënë pritshmëri shumë të larta për të gjithë fëmijët, pa marrë parasysh prejardhjen kombëtare, vendbanimin, statusin shoqëroro-ekonomik, gjininë, apo trashëgiminë kulturore.

b) Parimet kryesore në hartimin e përmbajtjeve të Standardeve të Shkollave Mike për Fëmijë

Për dallim prej parimeve të procesit të punës në zhvillimin e standardeve për shkollat mike për fëmijë, parimet kryesore për hartimin e përmbajtjeve të standardeve mbështeten në qasje, cilësi dhe respekt (UNICEF/UNESCO, 2007).


- **Qasja** - siguron që të gjithë nxënësit/nxënëset të kenë mundësinë për t'u përfshirë në procesin e të nxënës dhe të zhvillojnë shkathtësitë për të mësuarit gjatë gjithë jetës në një shkollë cilësore dhe me mundësi të barabarta;
- **Cilësia** – mbështet zhvillimin e dijeve të fakteve dhe procedurave, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, si dhe mbështetjen e zhvillimit kreativ dhe emocional të fëmijës;
- **Respekti** – vlerëson gjuhën, kulturën, shkathtësitë dhe pikëpamjet e secilit individ.



Të tri këto parime kanë qenë udhërrëfyes për hartuesit e Standardeve të Shkollave Mike në Kosovë. Respektimi i tyre është reflektuar me gjuhën e përdorur në dokument dhe me kërkesat drejtuar shkollave përmes treguesve për të siguruar për të gjithë fëmijët qasje, cilësi dhe respekt.

III. STRUKTURA DHE ORGANIZIMI I STANDARDEVE PËR SHKOLLAT MIKE PËR FËMIJË

Struktura e organizimit të Standardeve për Shkollat Mike për Fëmijë është e konceptuar nga aspektet e përgjithshme, drejt aspekteve të veçanta që influencojnë drejtpërdrejt në punën me nxënës. Ajo pasqyrohet në diagramin në vijim:



3.1. Si definohen konceptet e strukturës së organizimit të Standardeve për Shkollat Mike për Fëmijë?

Dimensionet

Janë koncepte që burojnë nga parimet e shkollave mike për fëmijë dhe ndihmojnë organizimin e standardeve. Ato përcaktojnë masën e shtrirjes së organizimit të standardeve për një pjesë të caktuar të konceptit të shkollave mike për fëmijë.

Standardet

Janë struktura bazë e këtij dokumenti. Standardet në këtë dokument paraqiten si deklarata të përgjithshme, të cilat përcaktojnë pritjet që duhen të arrihen në arsim. Ato përcaktojnë kritere dhe kërkesa që duhet t'i plotësojnë shkollat, përcaktojnë kritere çka duhet të dinë dhe të bëjnë palët e interesit në sistemin e arsimit në mënyrë që të arrijnë arsim cilësor. Shërbejnë për ta vlerësuar dhe vetëvlerësuar zhvillimin dhe efektivitetin e shkollës.

Treguesit

Janë veprime, sjellje të dukshme dhe të matshme që përdoren për të vlerësuar zhvillimin dhe arritjen e standardeve. Treguesit e Standardeve të Shkollave Mike për Fëmijë përshkruajnë çka duhet të ketë ose çka duhet bërë shkolla që të arrihen standardet e caktuara në nivel të shkollës. Për secilin standard janë hartuar tregues, të cilët janë ndarë në tre komponentë të shkollës: menaxhimi dhe qeverisja, kapaciteti i shkollës si dhe kurrikula e procesi mësimor.

Komponentët e shkollës.


Janë përbërësit e strukturës dhe organizimit të punës në shkollë të specifikuar në kontekstin e Standardeve të Shkollave Mike për Fëmijë për adresimin e treguesve sipas përgjegjësve kryesorë. Ndarja është bërë me qëllim që në secilin komponent të intervenohet me kohë dhe në mënyrë të duhur, në treguesit përkatës, në mënyrë që edhe arritja e tyre të jetë me e lehtë dhe me funksionale në raport me standardet përkatëse. Ndarja është bërë për çështje praktike të organizimit dhe zbatimit të treguesve.

3.2. Cilat janë dimensionet e Standardeve për Shkollat Mike për Fëmijë në Kosovë?

Koncepti “Shkollat mike për fëmijë” paraqet një qasje multidimensionale për përmirësimin e cilësisë së arsimit. Dimensionet përcaktohen në mënyrë specifike varësisht nga nevojat e shoqërisë. Në Kosovë, koncepti “Shkollat mike për fëmijë” përkufizohet me gjashtë dimensionet:


- 1 • Gjithëpërfshirja
- 2 • Efektiviteti i mësimdhënies dhe nxënies
- 3 • Shëndeti, mjedisi dhe siguria
- 4 • Pjesëmarrja demokratike
- 5 • Barazia gjinore
- 6 • Diversiteti kulturor

Ndarja në disa dimensione është bërë për çështje praktike. Në esencë të gjitha janë të ndërlidhura dhe vetëm si të integruara përfaqësojnë filozofinë e konceptit “Shkollat mike për fëmijë”. Ndërlidhja e tyre pasqyrohet në diagramin në vijim:



3.3. Si ndërlidhet koncepti i shkollave mike për fëmijë me qasjen gjithëpërfshirëse në arsim?

Koncepti i Shkollave Mike për Fëmijë (SHMF) mbështetet në Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF) dhe paraqet qasje gjithëpërfshirëse që ndërlidh aspektet e reformës në arsim dhe vendos fëmijën në qendër të vëmendjes në të gjitha aktivitetet që organizohen dhe zbatohen në shkollë. Pra, gjithçka që realizohet në shkollë dhe gjithkush që i realizon ato duhet të sillen rreth interesave të nxënësve.



3.4. Çfarë përmbajnë përkufizimet e secilit dimension të Standardeve të Shkollave Mike për Fëmijë në Kosovë?

Ekipi për hartimin e Standardeve për Shkollat Mike për Fëmijë, pasi ka arritur konsensus në ndarjen e dimensioneve, duke u bazuar në kontekstin e arsimit në Kosovë, ka bërë përkufizimet e dimensioneve, të cilat janë platformë e standardeve dhe treguese për dimensione. Dimensionet e Standardeve për Shkollat Mike për Fëmijë në Kosovë janë përkufizuar si në vijim:

1. Gjithëpërfshirja

Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të barabartë për arsim themelor, të obligueshëm dhe cilësor. Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të kenë qasje, përkushtim, rritje të pjesëmarrjes dhe cilësi në procesin e mësimin pavarësisht moshës, gjinisë, përkatësisë etnike, racore, religjioze, shëndetësore, nivelit shoqëror, ekonomik dhe aftësive e mundësive të fëmijëve. Arsimi gjithëpërfshirës siguron njohje, pranim dhe respekt për të gjithë fëmijët.

2. Efektiviteti i mësimdhënies dhe nxënies

Mësimdhënia ka nxënësin/nxënësen në qendër, merr për bazë mundësitë, nevojat, interesat dhe respekton stilet e të mësuarit të secilit/secilës për të zhvilluar maksimalisht potencialet e tij /saj në harmoni me kërkesat e kurrikulës (shoqërisë) për ta përgatitur atë qytetar aktiv dhe për përballje me sfidat e jetës. Efektiviteti në mësimdhënie arrihet përmes zbatimit të strategjive e teknikave të mësimdhënies që reflektojnë ndërveprim gjatë procesit të mësimin dhe që kërkojnë zhvillim profesional të mësimdhënësve për arritjen e kompetencave.

3. Shëndeti, mjedisi dhe siguria

Shkolla është një mjedis i dashur dhe i sigurt që ofron mirëqenie fizike, psikike dhe sociale për secilin nxënës/nxënëse. Nxënësi/nxënësja merret parasysh gjatë adresimit të faktorëve që kanë të bëjnë me shpërdorimin psikologjik dhe atë fizik, të ushqyerit e dobët dhe hapësirës së pasigurt fizike. Adresimi i drejtë i këtyre faktorëve dukshëm e përmirëson vijimin, pjesëmarrjen dhe performancën në shkolla.

4. Pjesëmarrja demokratike

Shkolla promovon të drejtat dhe pjesëmarrjen demokratike të nxënësve, mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në proceset shkollore dhe aktivitetet jashtëshkollore, duke u mundësuar të shprehin lirshëm mendimet e tyre, të marrin pjesë në zgjidhjen e problemeve dhe në marrjen e vendimeve që janë në interes për nxënësit.

5. Barazia gjinore

Të gjitha vajzat dhe të gjithë djemtë kanë mundësi të barabarta për një pjesëmarrje të plotë në procesin mësimor që i adreson nevojat themelore dhe unike të vajzave dhe djemve; sigurohen materiale mësimore pa diskriminim gjinor dhe që mbështesin realizimin e të drejtave të njeriut.

Diversiteti kulturor

Shkolla u siguron të gjithë fëmijëve të drejtën themelore për arsim dhe mundësi të barabarta pa dallim të origjinës, identitetit kulturor, gjuhës, aftësive, apo rrethanave ekonomike, respektim të vlerave e shoqërisë, të bashkëjetesës në shoqëri, si dhe të qenit qytetar aktiv në botën e ndërvuar.

3.5. Cilat janë standardet e përcaktuara sipas dimensioneve të konceptit “Shkollat mike për fëmijë”?

Në kuadër të secilit dimension, janë përcaktuar një numër i standardeve që në esencë përfaqësojnë aspektet kryesore të dimensionit përkatës. Përmes standardeve pritjet të vlerësohen arritjet për dimensionet e konceptit “Shkollat mike për fëmijë”.

Tabela në vijim prezanton standardet e përcaktuara për secilin dimension të konceptit “Shkollat mike për fëmijë”:


Nr.	Dimensionet	Standardet
1	Gjithëpërfshirja	<p>Standardi 1: Të gjithë fëmijët kanë mundësi të barabarta për t’u regjistruar në shkollë, për ta vijuar dhe për ta përfunduar atë.</p> <p>Standardi 2: Të gjithë fëmijët kanë qasje dhe përfshihen në mënyrë aktive në programe kurrikulare dhe aktivitetet të lira në shkollë.</p> <p>Standardi 3: Të gjithë fëmijët pranohen dhe trajtohen në mënyrë të barabartë nga të gjithë në shkollë, dallimet që ekzistojnë në mes tyre shikohen si mundësi për pasurimin e procesit mësimor.</p>
2	Efektiviteti në mësimdhënie	<p>Standardi 1: Të gjithë nxënësit/nxënëset angazhohen në mënyrë aktive në procesin e mësimin dhe përkrahen në zhvillimin e potencialeve të tyre.</p> <p>Standardi 2: Mundësitë, nevojat dhe interesat e nxënësit/nxënëses gjatë procesit të mësimin janë në fokus të mësimdhënies që realizohet me metodologji të ndryshme.</p> <p>Standardi 3: Mësimdhënësit janë kompetent, të motivuar dhe ata veprojnë sipas kërkesave për kompetenca të mësimdhënësve.</p>
3	Shëndeti, mjedisi dhe siguria	<p>Standardi 1: Shkolla kujdeset për shëndetin fizik dhe mendor të gjithë nxënësve.</p> <p>Standardi 2: Nxënësit/nxënëset ndihen të sigurt-a dhe të dashur-a në shkollë.</p> <p>Standardi 3: Nxënësit/nxënëset mësojnë në një mjedis të mbrojtur nga lëndimet fizike, fatkeqësitë elementare dhe rreziqet e tjera.</p>

4	Pjesëmarrja demokratike	<p>Standardi 1: Nxënësit shprehin lirshëm mendimet e tyre, janë pjesëmarrës në vendimmarrje të çështjeve të ndryshme, në aktivitete të ndryshme në shkollë dhe jashtë shkollës.</p> <p>Standardi 2: Mësimdhënësit shprehin mendimet e tyre, interesim dhe marrin vendime, për organizimin efektiv të mësimdhënies për arsimim cilësor të nxënësve dhe për çështje të ndryshme të interesit.</p> <p>Standardi 3: Prindërit janë pjesëmarrës aktivë dhe partnerë në realizimin e procesit të mësimit dhe në marrjen e vendime për çështjet që kanë të bëjnë me arsimin dhe edukimin e fëmijëve të tyre.</p> <p>Standardi 4: Shkolla nxit komunitetin që ta mbështes sigurimin e arsimit cilësor për të gjithë nxënësit.</p>
5	Barazia gjinore	<p>Standardi 1: Vajzat dhe djemtë kanë mundësi të barabarta, trajtohen drejt në aspektin gjinor.</p> <p>Standardi 2: Vajzat dhe djemtë përgatiten përmes kurrikulës dhe procesit mësimor që të sillen në përputhje me konceptin e barazisë gjinore.</p> <p>Standardi 3: Shkolla punon në arritjen e bilancit gjinor, veçmas në matematikë, shkencë dhe teknologji.</p>
6	Diversiteti kulturor	<p>Standardi 1: Të gjithë fëmijët përgatiten të jetojnë në një shoqëri me ndryshime kulturore dhe ta respektojnë atë.</p> <p>Standardi 2: Të gjithë fëmijët kuptojnë vlerat e shoqërisë, të bashkëjetesës në shoqëri, si dhe të qenit qytetar aktiv në botën e ndërruar.</p>

3.6. Treguesit e Standardeve të Shkollave Mike për Fëmijë dhe organizimi i tyre

Vlerësimi për arritjen e një standardi të caktuar është vështirë të bëhet pa u mbështetur në tregues specifikë që tregojnë arritjen e standardit përkatës. Prandaj, për të gjitha standardet e paraqitura më lart janë hartuar tregues të veçantë, përmes të cilëve secila shkollë mund të bëjë vetëvlerësim për arritjen e secilit standard të dimensioneve të konceptit “Shkollat mike për fëmijë”.

Për çështje praktike, organizimi i treguesve është ndarë në tre komponentë, fusha të shkollës:



Çfarë aspektesh matin treguesit e ndarë sipas komponentëve/ fushave të shkollës?


1. Në komponentin **Menaxhimi dhe qeverisja** grupohen treguesit, të cilët matin dhe vlerësojnë punën e personelit udhëheqës të shkollës në të cilën hyjnë: *përmbajtja e dokumenteve të shkruara në shkollë, punët që janë përgjegjësi e drejtorit, punët që janë përgjegjësi e Këshillit drejtues të shkollës dhe punët që janë përgjegjësi e Këshillit të prindërve, e Këshillit të nxënësve.*
2. Në komponentin **Kapaciteti i shkollës** grupohen treguesit, të cilët matin dhe vlerësojnë aspektet, të cilat i ofron shkolla si janë: *kompetencat e mësimdhënësve/seve,, kompetencat e shërbimit profesional, kapacitetet e gjendjes fizike të shkollës (oborri, ndërtesa shkollore, korridoret dhe hapësirat e tjera).*
3. Në komponentin **Kurrikula dhe procesi mësimor** grupohen treguesit, të cilët matin dhe vlerësojnë: *kurrikulën, metodat për realizimin e mësimit, gjendjen me materiale mësimore, përdorimin e kompjuterit/teknologjisë informative, mjeteve dhe pajisjeve të tjera në mësim, organizimin dhe zbatimin e aktiviteteve jashtëshkollore dhe jashtëmësimore, raportin e mësimdhënësve jashtë orës (në aktivitete jashtëmësimore dhe jashtëshkollore).*

3.7. Organizimi i treguesve të standardeve në komponentë – fusha zhvillimore të shkollës

Vendosja e standardeve për secilin dimension të Shkollave Mike për Fëmijë është bërë pasi që është arritur një konsensus për përkufizimin e secilit dimension. Kjo nënkupton se standardet në thelb përfshijnë segmentet kryesore të dimensioneve përkatëse.

Matja e arritjes së standardeve është dizajnuar të bëhet përmes vlerësimit të arritjes së treguesve, prandaj një vëmendje e veçantë i është kushtuar përgatitjes së treguesve për secilin standard. Pasi që grupi punues i ka hartuar treguesit për standarde, ka bërë organizimin e tyre në komponentë – fusha zhvillimore të shkollës. Kjo është bërë me qëllim të gjetjes së pikave kryesore të referimit për marrjen e përgjegjësisë për zhvillimin e aktiviteteve përkatëse në arritjen e treguesve të fushës zhvillimore përkatëse dhe rrjedhimisht në arritjen e standardeve në nivel të shkollës.

Skema në vijim, pasqyron lidhjen në mes të dimensioneve me standarde dhe organizimin e treguesve në komponentë – fusha zhvillimore të shkollës.



DIMENSIONI: GJITHËPËRFSHIRJA

Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të barabartë për arsim themelor, të obligueshëm dhe cilësor. Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të kenë qasje, përkushtim, rritje të pjesëmarrjes dhe cilësi në procesin e të mësuarit, pavarësisht moshës, gjinisë, përkatësisë etnike, racore, religjioze, shëndetësore, nivelit shoqëror, ekonomik dhe aftësive e mundësive të fëmijëve. Arsimi gjithëpërfshirës siguron njohje, pranim dhe respekt për të gjithë fëmijët.

Fushat zhvillimore të shkollës	Standardi 1: Të gjithë fëmijët kanë mundësi të barabarta për t'u regjistruar në shkollë, për ta vijuar dhe për ta përfunduar atë.
1. Menaxhimi dhe qeverisja	<p>Treguesit</p> <p>1.1. Shkolla bashkëpunon me Zyrën e regjistrimit civil dhe merr prej saj listën e të gjithë fëmijëve të moshës shkollore të zonës. Respekton rregulloren e komunës për rajonalizimin e shkollave.</p> <p>1.2. Shkolla ka formuar komisionin në nivel shkolle për vlerësim dhe regjistrim të fëmijëve, siguron formularët për vlerësim dhe regjistrim të fëmijëve në shkollë dhe i përmbahet asaj.</p> <p>1.3. Shkolla ka përgatitur bazën e të dhënave me evidenca të nxënësve të regjistruar dhe të dhëna të tjera për nxënësit dhe shkollën - sipas modelit të statistikave të SMIA-s.</p> <p>1.4. Shkolla ka ekipin funksional për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit- (EPRBM).</p> <p>1.5. Shkolla ka marrëveshje të bashkëpunimit dhe bashkëpunon me organizata dhe institucione që ndihmojnë sigurimin e gjithëpërfshirjes në shkollë.</p> <p>1.6. Shkolla ka planin e trajnimit të mësimdhënësve dhe personelit për gjithëpërfshirjen në arsim.</p> <p>1.7. Shkolla ka procedura³ të hartuara për identifikimin dhe analizën e shkaqeve për përsëritjen e vitit shkollor dhe ndërmerr masa me kohë për zvogëlimin e numrit të nxënësve që përsërisin klasën.</p> <p>1.8. Shkolla ka procedura të hartuara dhe i respekton ato për informimin e nxënësve për mundësitë e shkollimit të mëtutjeshëm, edukimin në karrierë, etj.</p>

³ Me procedura nënkuptojmë rendin logjik të zbatimit të aktiviteteve, marrjes së masave, përdorimit të mjeteve, resurseve, etj. që mundësojnë arritjen e një qëllimi të dhënë. Procedurat e hartuara nga vetë shkolla mund të ndryshojë nga njëri kontekst në tjetrin dhe nga njëra shkollë në tjetrën.

<p>2. Kapaciteti i shkollës</p>	<p>1.9. Shkolla ka mësime të mjaftueshëm dhe të kualifikuar që sigurojnë mësime në të gjitha lëndët mësimore/fushat kurrikulare.</p> <p>1.10. Shkolla bashkëpunon me ekipet profesionale vlerësuese dhe këshilluese në nivel komunal dhe qendror (mjekë, psikologë, pedagogë dhe specialistë në fusha të tjera të ngushta) për përfshirje në shkollë të gjithë fëmijëve.</p> <p>1.11. Shkolla ndërmerr aktivitete të ndryshme për të siguruar përfshirje dhe pjesëmarrje të gjithë nxënësve në shkollë (fushata informuese, vizita familjeve, bashkëpunim me institucione, komunitetin, prindër, OJQ dhe me media).</p> <p>1.12. Shkolla shfrytëzon hapësirat për zhvillimin e procesit mësimor dhe aktiviteteve të tjera, në përputhje me numrin e nxënësve dhe nevojat e tyre.</p> <p>1.13. Shkolla ka infrastrukturë të përshtatshme që mundëson qasje fizike për të gjithë nxënësit/set (dhoma mësimi, hapësira komunikimi, dyer, pjerrina, tualete, etj.).</p> <p>1.14. Shkolla ka inventarin e nevojshëm në sasi dhe ai inventar është i përshtatshëm sipas niveleve dhe nevojave të arsimit të gjithë nxënësve.</p> <p>1.15. Shkolla u mundëson të gjithë nxënësve që u përkasin komuniteteve të ndryshme etnike të mësojnë në gjuhën e tyre amtare ose ta mësojnë atë si lëndë të veçantë.</p> <p>1.16. Shkolla ka siguruar transport të qëndrueshëm për bartjen e fëmijëve me nevojë për në shkollë.</p> <p>1.17. Shkolla përgatit raport të ndjekjes së arritjeve të nxënësve gjatë kalimit prej një klase në klasën tjetër dhe prej një cikli në ciklin tjetër në fund të çdo gjysmëvjetori.</p>
<p>3. Kurrikula dhe procesi mësimor</p>	<p>1.18. Mësime të mjaftueshëm kanë planet dhe raportet e zbatimit të mësimit gjithëpërfshirës dhe ato të bashkëpunimit me kolegë dhe me prindër.</p> <p>1.19. Mësime të mjaftueshëm mbajnë shënime të rregullta për arritjet e nxënësve, vijueshmërinë në mësim dhe sjelljet e secilit nxënës.</p> <p>1.20. Mësime të mjaftueshëm kujdestarë klase përgatisin raporte dhe analiza të rregullta tre mujore për paralelen e tyre, duke u mbështetur në shënime individuale të nxënësve. Rezultatet shfrytëzohen për përmirësimin e procesit mësimor.</p> <p>1.21. Mësime të mjaftueshëm i pranojnë të gjithë nxënësit/et pa marrë parasysh dallimet e tyre dhe u qasen me gjuhë të përshtatshme që rrit besimin dhe motivimin e tyre që të mësojnë dhe përfundojnë</p>

	<p>me sukses nivelin e shkollimit të cilin e vijnë.</p> <p>1.22. Mësimdhënësit/et dhe nxënësit/et identifikojnë nxënësit/et e rrezikuar/a për “largim” nga mësimi dhe shkolla për shkak të ndikimit të faktorëve të ndryshëm.</p> <p>1.23. Mësimdhënësit/et dhe nxënësit/et ndihmojnë në tejkalimin e vështirësive dhe zgjidhjen e problemeve të nxënësve, duke u ofruar orë mësimore shtesë dhe bashkëpunim në detyra, e aktivitete mësimore.</p>
Fushat zhvillimore të shkollës	Standardi 2: Të gjithë fëmijët kanë qasje dhe përfshihen në mënyrë aktive në programe kurrikulare dhe aktivitetet të lira në shkollë.
1. Menaxhimi dhe qeverisja	<p>Treguesit</p> <p>2.1. Shkolla ka krijuar mekanizma⁴ për identifikimin e nevojave, mundësive dhe interesimeve të gjithë fëmijëve për përfshirje në programe kurrikulare dhe aktivitete të lira në shkollë që mundësojnë zhvillimin maksimal të potencialeve të tyre.</p> <p>2.2. Shkolla ka hartuar planin e veprimit për përfshirje aktive të gjithë fëmijëve në aktivitete mësimore dhe në aktivitete të lira në shkollë dhe e zbaton atë.</p> <p>2.3. Shkolla ka krijuar mundësi që nxënësit, prindërit dhe komuniteti të marrin pjesë në procesin e hartimit të kurrikulës zgjedhore.</p> <p>2.4. Shkolla ka rregullore në harmoni me dispozitat ligjore për sigurimin e mjeteve materiale për nxënës që për shkaqe ekonomike nuk mund të ndjekin mësimin apo nuk mund të përfshihen në aktivitete të lira, të cilat kërkojnë mjete plotësuese (p.sh. ekskursione, gara, shfaqje).</p> <p>2.5. Shkolla ka sistem për identifikimin dhe përkrahjen e nxënësve që kanë vështirësi në mësim, të nxënësve me talent të veçantë, si dhe të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe vazhdimisht ndjek përparimin e tyre.</p> <p>2.6. Shkolla ka procedura dhe kritere për hartimin, miratimin dhe zbatimin e mësimin plotësues dhe mësimin shtues.</p>
2. Kapaciteti i shkollës	<p>2.7. Shkolla ka kapacitete dhe ofron përkrahje për hartimin e PIA-s dhe zbatimin në praktikë.</p> <p>2.8. Shkolla ofron përkrahje për zbatimin e programeve kurrikulare dhe aktiviteteve të lira në të cilat kanë qasje të gjithë nxënësit.</p> <p>2.9. Shkolla ka përfshirë të gjithë nxënësit/et në së paku një aktivitet</p>

⁴ Me mekanizma nënkuptojmë aktivitete të veçanta, procedura dhe mjete që mundësojnë arritjen e një qëllimi të dhënë. Mekanizmi mund të ndryshojë nga njëri kontekst në tjetrin dhe nga njëra shkollë në tjetrën.

	<p>jashtë-kurrikular (sipas interesimeve të tyre dhe sipas kërkesave të shoqërisë për të mbështetur zhvillimin e tyre personal dhe shoqëror).</p> <p>2.10. Shkolla siguron që praktikat për vlerësimin e nxënësve të jenë të drejta, të përshtatshme, të vazhdueshme, transparente dhe të balancuara.</p> <p>2.11. Shkolla është e pajisur me mjete mësimore/didaktike në përputhje me kërkesat e kurrikulit dhe nevojat e nxënësve, si dhe i shfrytëzon ato në mënyrë racionale.</p> <p>2.12. Shkolla ka dhe shfrytëzon mjetet adekuate për afirmimin e krijimeve të nxënësve dhe aktiviteteve të lira në shkollë (p.sh. gazeta e shkollës, ueb-faqja e shkollës, këndi shkollor i informimit, radio e shkollës, etj.</p> <p>2.13. Shkolla ofron shërbime interneti dhe teknologji tjetër për të nxitur dhe përkrahur aktivitetet që sigurojnë përfshirjen aktive të nxënësve në aktivitete kurrikulare dhe aktivitete të lira në shkollë.</p>
<p>3. Kurrikula dhe procesi mësimor</p>	<p>2.14. Mësimdhënësit/et bëjnë përshtatjen e kurrikulës, zhvillojnë mësimdhënien dhe vlerësimin në harmoni me nevojat, interesat dhe stilet e të nxënësve.</p> <p>2.15. Mësimdhënësit/et mbështesin nxënësit që kanë vështirësi në mësim, nxënësit/et me nevoja të veçanta arsimore, si dhe nxënësit/et me talente të veçanta, duke zgjedhur aktivitete sipas nevojave dhe mundësive të nxënësve.</p> <p>2.16. Mësimdhënësit/et hartojnë dhe zbatojnë PIA-në për nxënës/e me nevoja të veçanta në arsimim.</p> <p>2.17. Nxënësit/et janë të përfshirë në përgatitjen e programit të punës për aktivitete të lira në shkollë dhe jashtë saj.</p> <p>2.18. Mësimdhënësit/et kanë plane bashkëpunimi dhe bashkëpunojnë me kolegë dhe ekspertë brenda dhe jashtë shkollës për zbatimin e praktikave të mësimdhënies gjithëpërfshirëse.</p>
<p>Fushat zhvillimore të shkollës</p>	<p>Standardi 3: Të gjithë fëmijët pranojnë dhe trajtohen në mënyrë të barabartë nga të gjithë në shkollë, dallimet që ekzistojnë në mes tyre shikohen si mundësi për pasurimin e procesit mësimor.</p>
<p>1. Menaxhimi dhe qeverisja</p>	<p>3.1. Shkolla ka krijuar mekanizma që sigurojnë se të gjithë fëmijët trajtohen në mënyrë të drejtë, të barabartë, me dinjitet dhe respekt.</p> <p>3.2. Shkolla ka rregulla të sjelljes në shkollë, të cilat nuk diskriminojnë fëmijët dhe nuk lejojnë diskriminimin e tyre.</p> <p>3.3. Shkolla ka përfshirë në Këshillin drejtues të shkollës dhe në këshillat e prindërve edhe prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore.</p>

	<p>3.4. Shkolla merr vendime të bazuara në kërkesat e shoqërisë dhe pritjet e komunitetit të shkollës për trajtim të barabartë të gjithë fëmijëve.</p> <p>3.5. Shkolla ka planin zhvillimor të shkollës në të cilin pasqyrohet qartë misioni i shkollës gjithëpërfshirëse dhe miqësore.</p>
2. Kapaciteti i shkollës	<p>3.6. Personeli profesional (pedagogu, psikologu, sociologu) në shkollë dhe mësimdhënësit/et janë trajnuar të respektojnë dallimet e cilësdo natyrë dhe të reagojnë ndaj çfarëdo diskriminimi të nxënësve dhe personelit të shkollës dhe në këtë mënyrë të kontribuojnë në krijimin e perceptimeve të drejta të nxënësit/et.</p> <p>3.7. Shkolla prezanton në forma të ndryshme kulturën e shkollës, kulturën dhe trashëgiminë e komunitetit që përfaqëson.</p> <p>3.8. Shkolla bashkëpunon me prindër dhe partnerë të tjerë për të promovuar pranimin dhe respektimin e të gjithë fëmijëve si brenda shkollës ashtu edhe jashtë saj.</p>
3. Kurrikula dhe procesi mësimor	<p>3.9. Mësimdhënësit zbatojnë strategji të ndryshme të menaxhimit të klasës që minimizojnë të gjitha llojet e pengesave në mësim dhe përfshijnë të gjithë nxënësit në aktivitete mësimore.</p> <p>3.10. Mësimdhënësit zhvillojnë planifikimin e kurrikulës që nxisin pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve në mësim.</p> <p>3.11. Mësimdhënësit përdorin tekste dhe krijojnë materiale mësimore gjatë punës me nxënës në mënyrë të balancuar, me paanshmëri dhe pa diskriminim. Gjatë punës me nxënës i prezantojnë ndryshimet në mes të njerëzve dhe vlerat e tyre.</p> <p>3.12. Mësimdhënësit i mësojnë nxënësit t'i njohin situatat e veçanta të diskriminimit në shkollë dhe jashtë saj dhe të reagojnë ndaj tyre në mënyrë konstruktive.</p> <p>3.13. Mësimdhënësit ndërtojnë marrëdhënie pozitive reciproke me nxënës/e dhe prindërit e tyre, duke përdorur qasje dhe komunikim të përshtatshëm me ta.</p> <p>3.14. Mësimdhënësit nuk i kritikojnë nxënësit/et para nxënësve të tjerë ose para prindërve.</p>

DIMENSIONI: EFEKTIVITETI NË MËSIMDHËNIE DHE NXËNIE

Mësimdhënia ka nxënësin/nxënësen në qendër merr për bazë mundësitë, nevojat, interesat dhe respekton stilet e të nxënit të secilit/secilës për të zhvilluar maksimalisht potencialet e tij /saj në harmoni me kërkesat e kurrikulës (shoqërisë) për ta përgatitur atë qytetar aktiv dhe për përballje me sfidat e jetës. Efektiviteti në mësimdhënie arrihet përmes zbatimit të strategjive e teknikave të mësimdhënies që reflektojnë ndërveprim gjatë procesit të mësuarit dhe që kërkojnë zhvillim profesional të mësimdhënësve për arritjen e kompetencave.

Fushat zhvillimore të shkollës	Standardi 1: Të gjithë nxënësit/nxënëset angazhohen në mënyrë aktive në procesin e mësimin dhe përkrahen në zhvillimin e potencialeve të tyre.
1. Menaxhimi dhe qeverisja	<p style="text-align: center;">Treguesit</p> <p>1.1. Shkolla ka krijuar një sistem të informimit të rregullt dhe me kohë të prindërve për pjesëmarrjen e fëmijëve të tyre në procesin e mësimin dhe për rezultatet e arritura.</p> <p>1.2. Shkolla ka procedura për përfshirje të mësimdhënësve dhe stafit përcjellës në zhvillim profesional dhe instrumente për mentorim dhe monitorim në aktivitete të zhvillimit profesional.</p> <p>1.3. Shkolla ka hartuar planin e zhvillimit profesional të mësimdhënësve dhe ka siguruar përfshirjen e mësimdhënësve në programe trajnimi për metodologji të mësimdhënies që ndihmojnë angazhimin aktiv të gjithë nxënësve në procesin e mësimin.</p> <p>1.4. Shkolla ka procedurat dhe instrumentet për përfshirjen e gjithë faktorëve relevant me rastin e hartimit të kurrikulës me bazë në shkollë, varësisht nga nevojat e nxënësve dhe kërkesat e komunitetit.</p> <p>1.5. Shkolla ka planifikuar dhe ka siguruar me kohë materialin shpenzues në sasi të mjaftueshme, për realizimin e aktiviteteve mësimore dhe aktiviteteve të lira me nxënës/se.</p>
2. Kapaciteti i shkollës	<p>1.6. Interesat e nxënësve janë mbështetur në orarin mësimor të hartuar me kohë nga shkolla.</p> <p>1.7. Të gjithë nxënësit/et kanë qasje në programet kurrikulare, ndërkurrikulare dhe jashtëkurrikulare.</p> <p>1.8. Shkolla ka hapësira funksionale për mësim, të pajisura me materiale adekuate sipas nevojave për mësim.</p> <p>1.9. Shkolla i përdor hapësirat në dispozicion, mjetet dhe materialet e mësimdhënies në mënyrë të balancuar për të gjitha lëndët mësimore dhe paralelet e nxënësve për realizimin e aktiviteteve kurrikulare dhe jashtëkurrikulare.</p> <p>1.10. Shkolla krijon mjete mësimore dhe materiale të tjera ndihmëse</p>

	<p>për nevojat e mësimdhënies efektive.</p> <p>1.11. Shkolla ka siguruar programe softverike (elektronike) që janë në shërbim të mësimdhënies dhe të nxënit (p.sh. harta elektronike, programe nga matematika , mjedisi, shkencat etj).</p> <p>1.12. Zhvillimi i nxënësve përkrahet nga shërbimet profesionale që i siguron shkolla përmes bashkëpunimit ndërinstucional.</p> <p>1.13. Kërkesat e nxënësve për mësim shtesë dhe nevojat për mësim plotësues parashihen në planin e punës së shkollës dhe zbatohen sipas nevojave të nxënësve dhe afateve të përcaktuara.</p>
3. Kurrikula dhe procesi mësimor	<p>1.14. Arritjet e nxënësve mbikëqyren dhe vlerësohen në mënyrë sistematike nga mësimdhënësit/et.</p> <p>1.15. Aktivitetet me nxënës që realizohen nga mësimdhënësit/et nxisin ndërveprim gjatë procesit të mësimt.</p> <p>1.16. Nxënësit/et kanë qasje në programet kurrikulare, ndërkurrikulare dhe jashtëkurrikulare dhe motivohen në forma të ndryshme nga mësimdhënësit/et për pjesëmarrje aktivitete në mësim dhe aktivitete jashtëkurrikulare.</p> <p>1.17. Nxënësit/et dhe prindërit informohen rregullisht nga mësimdhënësit/et për arritjet e rezultateve në mësim të tyre/nxënësve.</p> <p>1.18. Nxënësit nxënë në harmoni me stilet e tyre të mësuarit, të cilën u ofron mësimdhënia.</p> <p>1.19. Nxënësit/et nxiten nga mësimdhënësit/et përmes formave dhe metodave të ndryshme që të mendojnë dhe të veprojnë në mënyrë të pavarur.</p> <p>1.20. Krijimet e nxënësve mbështetën nga shkolla për publikimin e tyre në shkollë dhe jashtë shkolle.</p>
Fushat zhvillimore të shkollës	Standardi 2: Mundësitë, nevojat dhe interesat e nxënësit/nxënësës gjatë procesit të mësimt janë në fokus të mësimdhënies që realizohet me metodologji të ndryshme.
1. Menaxhimi dhe qeverisja	<p>Treguesit</p> <p>2.1. Shkolla ka mekanizma për monitorim të zbatimit të metodologjive të mësimdhënies që mbështeten në mundësitë, nevojat dhe interesat e nxënësve.</p> <p>2.2. Shkolla ka procedura për dhe i zbaton ato për vetëvlerësimin të punës së shkollës.</p>

	<p>2.3. Shkolla ka procedura dhe i zbaton ato për formimin dhe funksionimin e organeve qeverisëse dhe profesionale në shkollë, si: Këshilli drejtues i shkollës, aktivet profesionale, këshillat e klasave dhe organet e tjera qeverisëse dhe profesionale në shkollë.</p> <p>2.4. Shkolla ka procedura dhe i zbaton ato për raportim të punës në shkollë, informim të rregullt për autoritetet kompetente dhe për publikim gjithëpërfshirës të rezultateve të punës në shkollë.</p>
<p>2. Kapaciteti i shkollës</p>	<p>2.5. Shkolla ka dhe përcjell literaturën aktuale profesionale të llojllojshme dhe ka mjete mësimore ndihmëse që ndihmojnë zbatimin e metodologjive të mësimdhënies që mbështeten në mundësitë, nevojat dhe interesat e nxënësve.</p> <p>2.6. Shkolla ofron shërbime të internetit, TIK-ut dhe shërbime të tjera teknologjike për qëllime të mësimdhënies dhe nxënies në shkollë.</p> <p>2.7. Organet profesionale të shkollës shkëmbejnë përvoja profesionale për mbështetje të procesit mësimor dhe zbatimit të kurrikulit shkollor.</p> <p>2.8. Shkolla bashkëpunon me autoritetet kompetente sipas nevojës për zbatimin e kurrikulit.</p> <p>2.9. Shkolla i zbaton dispozitat ligjore që e rregullojnë vlerësimin e nxënësve në shkollë.</p>
<p>3. Kurrikula dhe procesi mësimor</p>	<p>2.10. Mësimdhënësit/et përdorin TIK-un dhe mjete të tjera të konkretizimit të mësimit që t'ua lehtësojnë nxënësve procesin e të mësuarit.</p> <p>2.11. Mësimdhënësit/et shfrytëzojnë burime të ndryshme për mësimdhënie, duke mos u kufizuar vetëm në tekste shkollore.</p> <p>2.12. Mësimdhënësit/et mbajnë portfolion e nxënësve për të ndjekur përparimin e tyre.</p> <p>2.13. Vlerësimi i të arriturave të nxënësve, vetëvlerësimi i nxënësve dhe vetëvlerësimi i mësimdhënësit/es bëhet me metoda, teknika dhe instrumente adekuate.</p> <p>2.14. Nxënësit/et mësojnë përmes punës ekipore, përvojës personale dhe burimeve të ndryshme që më së miri i përshtaten përparimit të tyre</p> <p>2.15. Nxënësit/et përkrahen në forma të ndryshme nga mësimdhënësit për sigurimin e materialeve mësimore dhe për prezantimin e krijimeve të tyre.</p>

Fushat zhvillimore të shkollës	Standardi 3: Mësimdhënësit janë kompetentë, të motivuar dhe ata veprojnë sipas kërkesave për kompetenca të mësimdhënësve.
1. Menaxhimi dhe qeverisja	<p style="text-align: center;">Treguesit</p> <p>3.1. Shkolla ka rregullore të brendshme për mbikëqyrje dhe vlerësim të performancës së mësimdhënësve dhe ajo zbatohet vazhdimisht.</p> <p>3.2. Shkolla ka procedura të hartuara dhe i zbaton ato për realizimin e aktiviteteve për zhvillim profesional me bazë në shkollë.</p> <p>3.3. Shkolla ka procedura të hartuara dhe i zbaton ato për përfshirjen e mësimdhënësve dhe stafit tjetër në hartimin e kurrikulës që është në përgjegjësi të shkollës.</p> <p>3.4. Shkolla ka sistem të informimit të rregullt dhe të përfshirjes së mësimdhënësve për projektet zhvillimore të shkollës dhe për aktivitetet tjera.</p> <p>3.5. Drejtori i shkollës dhe shërbimi pedagogjik⁵ i shkollës rregullisht mbikëqyrin punën e mësimdhënësve dhe sigurojnë mbështetje të nevojshme, konstruktive dhe motivuese.</p>
2. Kapaciteti i shkollës	<p>3.6. Shkolla siguron për mësimdhënës/e të gjitha dokumentet për punën e mësimdhënësve dhe zhvillimin profesional të tyre.</p> <p>3.7. Shkolla zbaton kriteret e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve⁶.</p> <p>3.8. Shkolla u siguron të gjithë mësimdhënësve mjetet e nevojshme për zbatimin e mësimdhënies efektive dhe përkrah krijimin e mjeteve të mësimdhënies nga mësimdhënësit/et.</p> <p>3.9. Mësimdhënësit/et planifikojnë punën e tyre në kuadër të aktiveve profesionale, shkëmbejnë përvoja dhe ide për planifikim në forma të ndryshme të komunikimit dhe bashkëpunimit.</p> <p>3.10. Mësimdhënësit/et kanë planet vjetore, mujore, tematike dhe përgatitjet ditore që përmbajnë të gjitha elementet e domosdoshme për organizimin dhe realizimin e suksesshëm të kurrikulës.</p> <p>3.11. Shkolla ka raporte periodike brenda vitit shkollor, për përcjelljen e planifikimit dhe realizimit të punës së mësimdhënësve në të cilin përfshihen informata mbi përparimin e mësimdhënësve apo vështirësitë në këtë fushë dhe nevojat për mbështetje.</p>

⁵ Nëse ka shkolla shërbim pedagogjik.

⁶ Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, (2010). Kriteret dhe procedurat për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve, Prishtinë.

3. Kurrikula dhe procesi mësimor	<p>3.12. Mësimdhënësit/et i zbatojnë në praktikën e mësimdhënies kompetencat për zbatimin e kurrikulit.</p> <p>3.13. Mësimdhënësit/et i zbatojnë në praktikën e mësimdhënies kompetencat për metodologjinë e mësimdhënies dhe vlerësimin të nxënësve, duke zbatuar praktikatat e shkollave mike për fëmijë të identifikuar në të gjitha dimensionet.</p> <p>3.14. Mësimdhënësit/et i zbatojnë në praktikën e mësimdhënies kompetencat e përmbajtjeve akademike- lëndës mësimore.</p> <p>3.15. Mësimdhënësit/et i zbatojnë në praktikën e mësimdhënies kompetencat për teoritë e të mësuarit, sidomos kur e përshtatin mësimdhënien e tyre me stilet e të mësuarit të nxënësve.</p> <p>3.16. Mësimdhënësit/et i zbatojnë në praktikën e mësimdhënies kompetencat për marrëdhëniet profesionale.</p>
---	--

DIMENSIONI: SHËNDETI, MJEDISI DHE SIGURIA

Shkolla është një mjedis i dashur dhe i sigurt që ofron mirëqenie fizike, psikike dhe sociale për secilin nxënës/nxënëse. Nxënësit merren parasysh gjatë adresimit të faktorëve që kanë të bëjnë me shpërdorimin psikologjik dhe atë fizik, të ushqyerit e dobët dhe hapësirës së pasigurt fizike. Adresimi i drejtë i këtyre faktorëve dukshëm e përmirëson vijimin, pjesëmarrjen dhe performancën në shkolla.

Standardi 1: Shkolla kujdeset për shëndetin fizik dhe mendor të të gjithë nxënësve

Treguesit	
Menaxhimi dhe qeverisja	<p>1.1. Shkolla ka rregullore që siguron mjedis të shëndetshëm për nxënës/nxënëse dhe personelin e saj.</p> <p>1.2. Shkolla ka rregullore që siguron nxënësit/et gjatë vizitave jashtë shkollës.</p> <p>1.3. Shkolla ka hartuar rregullat e sjelljes që ndalojnë dukuritë jo të shëndetshme dhe vazhdimisht e monitoron zbatimin e tyre.</p> <p>1.4. Shkolla ka procedura të shkruara dhe i zbaton ato për kujdesin e nxënësve që për shkak të sëmundjeve kronike ose lëndimeve serioze fizike apo psikike mungojnë më gjatë nga mësimi i rregullt.</p> <p>1.5. Shkolla realizon aktivitete të përbashkëta me prindërit, komunitetin dhe institucione shëndetësore e sociale për shëndetin, zhvillimin e dhe mirëqenien e nxënësve.</p> <p>1.6. Shkolla bashkëpunon me institucionet shëndetësore për realizimin e kontrollimeve periodike-sistematike të nxënësve dhe mban raportet shëndetësore në dosjet e nxënësve.</p>
Kapaciteti i shkollës	<p>1.7. Ndërtesa e shkollës dhe oborri i saj kanë mjedise të shëndetshme (ndërtime me materiale me përbërje jo të dëmshme) në kuptimin fizik, biologjik, kimik, psikologjik dhe social.</p> <p>1.8. Ndërtesa e shkollës ka numër të mjaftueshëm të tualeteve dhe të pastra përherë për dy gjinitë, si për nxënës/ nxënëse ashtu dhe për personel të shkollës.</p> <p>1.9. Ndërtesa e shkollës ka vazhdimisht ujë të sigurt për pije dhe për nevoja të tjera.</p> <p>1.10. Shkolla ka sistem të përshtatshëm për deponim të mbeturinave, shporta të mjaftueshme për hedhjen e mbeturinave në të gjitha hapësirat e frekuentuara me nxënës /nxënëse dhe personel.</p> <p>1.11. Ndërtesa e shkollës ka hapësira për ushqim apo kuzhinë shkollore me ushqim të shëndetshëm.</p> <p>1.12. Shkolla ka ndriçim të mjaftueshëm natyror dhe elektrik, ngrohje dhe ajrosje të nevojshëm në të gjitha hapësirat.</p> <p>1.13. Shkolla ka hapësirat e duhura për zhvillimin e lëndës të edukatës fizike dhe aktiviteteve të lira sportive (si sallën e edukatës fizike me</p>

	<p>kthinat përcjellëse ashtu edhe hapësirat e hapura sportive dhe rekreative).</p> <p>1.14. Shkolla përdor mjete konkretizuese në mësim, të cilat nuk e dëmtojnë shëndetin e nxënësve.</p> <p>1.15. Shkolla ka plan të veprimit për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse.</p> <p>1.16. Shkolla ka mjetet e nevojshme për ndihmën e parë dhe sipas nevojës i ofron ato.</p> <p>1.17. Shkolla për intervenime serioze shëndetësore i dërgon nxënësit/nxënëset në qendrën më të afërt mjekësore.</p>
<p>Kurrikula dhe procesi mësimor</p>	<p>1.18. Shëndeti fizik dhe psikologjik i nxënësve është pjesë e procesit të mësimdhënies dhe të nxënit (si, respektimi aftësive të nxënësve duke u krijuar besim në vete, respektimi i kërkesave për mësim, interesave në mënyrë që të ndihen këndshëm apo komod, etj).</p> <p>1.19. Nxënësit zhvillojnë shkathtësitë për jetën përmes aktiviteteve kurrikulare, ndërkurrikulare apo jashtëkurrikulare, si gjatë realizimit të temave të edukimit shëndetësor, të edukimit seksual, të mbrojtjes së mjedisit, aktiviteteve të solidaritetit, tolerancës etj.</p> <p>1.20. Aktivitetet kurrikulare, por edhe aktivitete tjera që realizohen në shkollë, zhvillohen në forma relaksuese si në aspektin fizik, por edhe psikologjik.</p>
<p>Standardi 2: Nxënësit/nxënëset ndihen të sigurt-a dhe të dashur-a në shkollë</p>	
<p>Menaxhimi dhe qeverisja</p>	<p style="text-align: center;">Treguesit</p> <p>2.1. Shkolla ka rregulla të brendshme të sjelljes që e ndalojnë dhunën, ngacmimet psikologjike dhe fizike dhe monitoron vazhdimisht zbatimin e tyre.</p> <p>2.2. Rregullat e sjelljes në shkollë janë publike për të gjithë nxënësit/et e shkollës, mësimdhënësit/et dhe prindërit.</p> <p>2.3. Shkolla ka rregullore për vëzhgimin dhe monitorimin e objektit dhe oborrit të shkollës në aspektin fizik me qëllim të sigurimit të nxënësve dhe personelit shkollor dhe i përmbahet asaj vazhdimisht.</p> <p>2.4. Shkolla ka zhvilluar procedura për identifikimin dhe kujdesin për nxënësit/nxënëset me probleme psikologjike, pa marrë parasysh burimin e tyre (<i>p.sh dhuna familjare, shkurorëzimi i prindërve, sëmundje apo aksident në familje, traumat pas konflikteve, etj.</i>).</p> <p>2.5. Shkolla ka strategji se si t'i inkurajojë dhe t'u mundësojë mësimdhënësve të fitojnë njohuri dhe zhvillojnë shkathtësi të reja për parandalimin e ngacmimit, si dhe ballafaqimin me të (ndjekje të konferencave, seminareve, literaturës, etj).</p>

Kapaciteti i shkollës	<p>2.6. Shkolla ka krijuar rrjetin e bashkëpunimit funksional me personel profesionalë në ndihmë të nxënësve dhe familjeve të tyre që përballen me probleme psikologjike dhe sociale, si psikologë, pedagogë, polici etj.</p> <p>2.7. Shkolla ka forma pune dhe instrumente përmes së cilave mbledh informata dhe i trajton me përgjegjësi dilemat apo kërkesat e nxënësve me sugjerime për tejkalim të gjendjeve të natyrave të lehta psikologjike dhe sociale.</p> <p>2.8. Shkolla ka komunitete të ndryshme (komuniteti i nxënësve, prindërve, mësimdhënësve, etj.) që trajtojnë problemet sociale apo të natyrës psikologjike të moshatarëve dhe i ndihmojnë ata të ndihen të sigurt dhe të dashur në shkollë.</p>
Kurrikula dhe procesi mësimor	<p>2.9. Gjatë procesit mësimor, aktiviteteve të lira dhe pushimeve në mes të orëve të mësimit ka gjithmonë rregull dhe disiplinë që siguron që nxënësit të ndihen të sigurt.</p> <p>2.10. Raportet e shëndosha sociale e psikologjike janë pjesë e procesit mësimor në shkollë, si komunikimi i sqartë dhe pa tension, respektim i mendimit, etj.</p> <p>2.11. Aktivitete kurrikulare, por edhe të tjera që kanë për temë çështje konflikti apo dhune, zhvillohen me metodologji që nxisin debat për gjetjen e mundësive për zgjidhje pa konflikt e dhunë.</p>
Standardi 3: Nxënësit/nxënëset mësojnë në një mjedis të mbrojtur nga lëndimet fizike, fatkeqësitë elementare dhe rreziqet e tjera	
Menaxhimi dhe qeverisja	<p style="text-align: center;">Treguesit</p> <p>3.1. Shkolla ka mekanizma për t'u marrë me rastet e fatkeqësive elementare apo me situata të tjera të rrezikut të përgjithshëm që paraqiten për nxënës/nxënëse dhe personelin shkollor.</p> <p>3.2. Shkolla bashkëpunon me autoritetet kompetente dhe institucionet (p.sh. me qendrat për siguri, zjarrfikësit dhe me policinë) për ngjarjet dhe informatat që kanë të bëjnë me sigurinë, dhunën dhe mbrojtjen e nxënësve.</p>
Kapaciteti i shkollës	<p>3.3. Ndërtesa e shkollës dhe oborri i saj janë fizikisht të sigurt dhe nuk paraqesin rrezik potencial për lëndimin e nxënësve, gjithashtu ato rregullisht mirëmbahen.</p> <p>3.4. Të gjitha vendet potenciale të rrezikshme në shkollë, që nuk mund të shmangën (p.sh. pusetat, shkallët, prizat elektrike, etj.) janë të shënuara me shenja të veçanta dhe nxënësit/et e personeli i shkollës janë të njoftuar me to.</p> <p>3.5. Shkolla ka sinjalizimet e duhura për alarmim në rast të fatkeqësive</p>

	<p>natyrore dhe rreziqeve të tjera, ka dyert dhe shkallët për evakuim, si dhe mjetet e nevojshme për lokalizimin e rreziqeve.</p> <p>3.6. Personeli është i trajnuar për ndërmarrjen e veprimeve dhe udhëzimin e fëmijëve në raste emergjente si dhe ofrimin e ndihmës fëmijëve dhe prindërve të tyre.</p>
<p>Kurrikula dhe procesi mësimor</p>	<p>3.7. Mësimdhënësit/et dhe nxënësit përdorin pajisjet mbrojtëse gjatë punës në laborator dhe në punëtori të shkollës me qëllim të mbrojtjes nga rreziqet dhe lëndimet.</p> <p>3.8. Nxënësit/nxënëset gjatë procesit të mësimin si në aktivitetet kurrikulare, por edhe ato jashtëkurrikulare i zhvillojnë njohuritë dhe shkathtësitë e nevojshme për veprim në raste të fatkeqësive natyrore dhe rreziqeve të tjera.</p> <p>3.9. Nxënësit/nxënëset, mësimdhënësit/et në bashkëpunim me komunitetin simulojnë së paku një herë në vit aktivitete konkrete për përgatitje për t'u mbrojtur nga rreziqet dhe fatkeqësitë e ndryshme (p.sh. zjarri, tërmeti, etj).</p>

DIMENSIONI: PJESËMARRJA DEMOKRATIKE

Shkolla promovon të drejtat dhe pjesëmarrjen demokratike të nxënësve, mësimitdhënësve, prindërve dhe komunitetit në proceset shkollore dhe aktivitetet jashtëshkollore, duke u mundësuar të shprehin lirshëm mendimet e tyre, të marrin pjesë në zgjidhjen e problemeve dhe në marrjen e vendimeve që janë në interes për nxënësit/et.

Standardi 1: Nxënësit shprehin lirshëm mendimet e tyre, janë pjesëmarrës në vendimmarrje të çështjeve të ndryshme, në aktivitete të ndryshme në shkollë dhe jashtë shkollës.

Treguesit	
Menaxhimi dhe qeverisja	<p>1.1. Shkolla ka mekanizma të definuar dhe procedura përmes së cilave nxënësit mund të shprehin mendimet e tyre dhe të jenë pjesë e vendimmarrjes në shkollë për çështje të ndryshme.</p> <p>1.2. Shkolla ka mekanizma që inkurajojnë nxënësit për pjesëmarrjen e tyre në zgjidhjen e problemeve të çështjeve të ndryshme që janë në interes për ta apo për shoqërinë.</p> <p>1.3. Shkolla siguron informacione të plota për nxënësit dhe i informon në mënyrë të drejtë, me kohë për politikën e arsimit dhe zhvillimet në shkollë (si, qëllimet e shkollës, ndryshimet e procedurave të ndryshme, ndryshimet në kalendarin shkollos dhe informacione të tjera të nevojshme).</p> <p>1.4. Shkolla ofron së paku një herë në tre muaj një raport për nevojat të brendshme, i cili përfshin trajtimin e kërkesave, vendimeve dhe vendimeve të nxënësve për çështje të ndryshme me interes për ta në shkollë dhe jashtë saj.</p> <p>1.5. Shkolla respekton të drejtat e fëmijëve dhe u siguron qasje në të gjitha dokumentet e të drejtave të njeriut dhe materialeve, të cilat zhvillojnë njohuritë për pjesëmarrjen aktive dhe demokratike.</p> <p>1.6. Shkolla ka sistem të përkrahjes së aktiviteteve të nxënësve në shkollë dhe jashtë shkolle që promovojnë vlerat demokratike.</p>
Kapaciteti i shkollës	<p>1.7. Nxënësit/nxënëset kanë komunitetin qeverisës – Këshillin e nxënësve në shkollë të zgjedhur në mënyrë demokratike nga vetë ata, në të cilin debatojnë, marrin nisma dhe vendime për çështje të ndryshme që janë në interes për ta.</p> <p>1.8. Nxënësit/nxënëset kanë komunitete të ndryshme në shkollë në të cilat shprehin kreativitetin e tyre, mendimet, marrin nisma dhe bëjnë punë vullnetare për zgjidhjen e çështjeve të ndryshme që janë me interes për ta dhe shoqërinë (grupet-klubet e artit, sportit, letrar, të shkencave, ekologëve, këshilltarëve social, politikanëve...).</p> <p>1.9. Nxënësit/nxënëset në shkollë kanë mundësi t'i shprehin në forma të ndryshme mendimet për çështje që i preokupojnë (p.sh. gazetatat e murit,</p>

	<p>përmbledhjet e rasteve, sistemi i adresave publike, kuti anonime, diskutime gjatë orëve të mësim, etj.)</p> <p>1.10. Nxënësit/nxënëset në shkollë kanë kushte fizike që e lehtësojnë pjesëmarrjen aktive të tyre në aktivitete të ndryshme kurrikulare dhe jashtëkurrikulare.</p>
<p>Kurrikula dhe procesi mësimor</p>	<p>1.11. Të gjitha aktivitetet kurrikulare dhe jashtëkurrikulare që zhvillohen me nxënësit/et, nxisin pjesëmarrjen e tyre aktive dhe demokratike gjatë procesit të nxënimit (format e komunikimit, puna në grup, rezultatet me konsensus, respektimi i rendit, respektimi i mendimit etj.).</p> <p>1.12. Nxënësit/nxënëset janë bashkëpunëtor/e të mësimdhënësit/es në zgjedhjen e metodologjive të mësimdhënies.</p> <p>1.13. Nxënësit/nxënëset janë bashkëpunëtor/e të mësimdhënësit/es në zgjedhjen e formave të vlerësimit të arritjeve të tyre dhe në vlerësimin e aktivitete mësimore.</p> <p>1.14. Nxënësit/et nxiten për pjesëmarrje aktive në aktivitete të ndryshme brenda procesit të drejtpërdrejtë mësimor, duke ua përshtatur mësimdhënien stileve të tyre të nxënies.</p>
<p>Standardi 2. Mësimdhënësit shprehin mendimet e tyre, interesim dhe marrin vendime, për organizimin efektiv të mësimdhënies për arsimim cilësor të nxënësve dhe për çështje të ndryshme të interesit.</p>	
<p>Menaxhimi dhe qeverisja</p>	<p>Treguesit</p> <p>2.1. Në shkollë ekzistojnë mekanizma të ndryshëm dhe procedura të përcaktuara, të cilat u mundësojnë mësimdhënësve të shprehin mendimet e tyre dhe të marrin vendime për çështje të ndryshme që janë në interes për nxënësit/et dhe për vete.</p> <p>2.2. Shkolla u siguron informacione të duhura dhe me kohë mësimdhënësve për zhvillimet në shkollë dhe për programet e politikave të arsimit në nivel lokal dhe kombëtar.</p> <p>2.3. Shkolla monitoron promovimin e qytetarisë demokratike të mësimdhënësve, si gjatë punës së drejtpërdrejtë me nxënës, por edhe të raporteve kolegjiale në aspekte të ndryshme p.sh. komunikim, marrje të nismave dhe vendimmarrjeve për çështje të ndryshme interesi.</p> <p>2.4. Shkolla ka sistem të përkrahjes së aktiviteteve të marra nga mësimdhënësit në shkollë apo jashtë shkolle që promovojnë vlerat demokratike.</p> <p>2.5. Shkolla u siguron mësimdhënësve qasje në literaturë, seminare apo konferenca në të cilat prezantohen apo debatohen çështje të demokracisë.</p>

Kapaciteti i shkollës	<p>2.6. Shkolla ka komunitete të ndryshme në të cilat mësimit janë pjesëmarrës aktiv (p.sh. organet profesionale të shkollës).</p> <p>2.7. Shkolla ka mekanizma, të cilat i përcjellin dhe i bëjnë transparente rezultatet e aktiviteteve të këshillave të ndryshme të mësimit në interes për shkollën (procesverbalet, vendimet, planifikimet, aktivitetet e parapara me nxënës).</p> <p>2.8. Shkolla ka forma të nxitjes dhe të krijimit të mundësive të mësimit për pjesëmarrje aktive në ngritjen profesionale e pedagogjike.</p> <p>2.9. Shkolla ka forma të nxitjes dhe të krijimit të mundësive të mësimit për pjesëmarrje aktive në organizime të ndryshme me karakter social e vullnetar.</p> <p>2.10. Shkolla monitoron dhe mbështet mësimit në promovimin e vlerave demokratike gjatë realizimit të aktiviteteve të ndryshme kurrikulare dhe jashtëkurrikulare.</p>
Kurrikula dhe procesi mësimor	<p>2.11. Mësimit/et e realizojnë pjesëmarrjen demokratike jo vetëm në përmbajtje, por edhe në procesin e mësimit.</p> <p>2.12. Mësimit/et në procesin mësimor përdorin metoda e teknika që nxisin pjesëmarrje demokratike të nxënësve në aktivitetet kurrikulare dhe jashtëkurrikulare.</p> <p>2.13. Mësimit/ja bashkëpunon me mësimit, me prindërit dhe me ekspertë për planifikimin e realizimit të kurrikulës në harmoni me kërkesat dhe nevojat e nxënësve.</p>
Standardi 3. Prindërit janë pjesëmarrës aktivë dhe partnerë në realizimin e procesit të mësimit dhe në marrjen e vendime për çështjet që kanë të bëjnë me arsimin dhe edukimin e fëmijëve të tyre.	
Menaxhimi dhe qeverisja	<p>Treguesit</p> <p>3.1. Shkolla ka procedura demokratike të përcaktuara dhe gjithëpërfshirëse për zgjedhjen e prindërve në organet e shkollës (këshillin drejtues dhe këshillin e prindërve) dhe i respekton ato.</p> <p>3.2. Shkolla ka sistem të përcaktuar për informimin e prindërve për rezultatet e fëmijëve të tyre, strukturën dhe organizimin e shkollës, aktivitetet që zhvillohen në shkollë dhe e zbaton atë rregullisht.</p> <p>3.3. Shkolla ka forma të nxitjes së prindërve për pjesëmarrje sipas nevojës në zbatimin e kurrikulave (si p.sh, pjesëmarrjes në planifikim, realizim të procesit direkt të mësimit në klasë, apo në institucione në të cilat punojnë prindërit, etj).</p> <p>3.4. Shkolla ka strategji për përfshirjen e prindërve në proceset që ndihmojnë zhvillimin e potencialeve të nxënësve si në fushën e infrastrukturës ashtu edhe në fushën e arritshmërisë së nxënësve.</p> <p>3.5. Shkolla nxit pjesëmarrjen e prindërve në organizime të ndryshme brenda shkollës, përfshirjen në projekte të ndryshme të ofruara nga shkolla dhe vet prindërit.</p>

Kapaciteti i shkollës	<p>3.6. Në shkollë ka struktura/komunitete funksionale (këshilli drejtues, këshilli i prindërve dhe grupe të krijuara për nevojat e shkollës) në të cilat prindërit mund të shprehin mendimet dhe të marrin pjesë në zgjidhjen e problemeve dhe në marrjen e vendimeve të çështje që janë në interes për nxënësit.</p> <p>3.7. Prindërit marrin raporte të rregullta periodike duke mos i kaluar afatet tre mujore me shkrim, me informata për rezultatet e fëmijëve të tyre për çdo lëndë mësimore, duke përfshirë edhe informatat për zhvillimin personal dhe social të fëmijës.</p> <p>3.8. Shkolla ndihmon në ngritjen e kapaciteteve të prindërve për edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të tyre, përmes formave të ndryshme (punëtorive, seminareve, literaturës).</p> <p>3.9. Shkolla organizon punëtori me prindër për t'i informuar ata për të drejtat e fëmijëve.</p> <p>3.10. Shkolla siguron transparencë të rezultateve të takimeve të organeve, në të cilat prindërit janë pjesëmarrës për të gjithë prindërit tjerë dhe palëve të tjera të interesit\komunitetit (p.sh. publikon procesverbalet e takimeve, planifikimeve - përmes formave të ndryshme).</p>
Kurrikula dhe procesi mësimor	<p>3.11. Prindërit janë pjesëmarrës në planifikimin individual të arsimit (PIAs) për fëmijët e tyre në harmoni me kurrikulat, mundësitë, nevojat dhe interesat e fëmijëve.</p> <p>3.12. Prindërit janë Kontribues të realizimit të aktiviteteve kurrikulare dhe jashtëkurrikulare qoftë përmes pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në mësimdhënie apo përmes formave të tjera si, sigurim të materialeve didaktike, vizitave në funksion të kurrikulës etj.</p>
<p>Standardi 4. Shkolla nxit komunitetin që ta mbështesë sigurimin e arsimit cilësor për të gjithë nxënësit</p>	
Menaxhimi dhe qeverisja	<p style="text-align: center;">Treguesit</p> <p>4.1. Shkolla ka krijuar një sistem të informatave të rregullta nga të cilat komuniteti njoftohet për të arriturat dhe zhvillimet në shkollë (për shembull, përmes takimeve brenda dhe/apo jashtë shkollës, njoftimeve me shkrim, e-mailit, revistave shkollore, fletushkave, etj.).</p> <p>4.2. Shkolla i mbështet dhe e pranon përfshirjen e vullnetarëve të komunitetit në aktivitetet e kurrikulës si dhe ato jashtëkurrikulare.</p> <p>4.3. Shkolla ka listën e organizatave që veprojnë në komunitet, planin e bashkëpunimit me to dhe vazhdimisht e zbaton atë.</p> <p>4.4. Shkolla ka forma të përcaktuara që të nxisin dhe sigurojnë për komunitetin, pjesëmarrje në zhvillimin dhe zbatimin e planeve zhvillimore dhe vjetore të shkollës.</p> <p>4.5. Shkolla ka forma të përcaktuara që nxisin dhe i mundësojnë komunitetit (siç është komuniteti lokal i biznesit, shërbimet civile, OJQ, etj.) të kontribuojnë në krijimin e kushteve më të mira të shkollës.</p>

Kapaciteti i shkollës	<p>4.6. Ekzistojnë organe të veçanta të pjesëmarrjes së përbashkët të përfaqësuesve të shkollës dhe komunitetit, të cilët takohen rregullisht dhe veprojnë sipas planeve dhe programeve të shkruara.</p> <p>4.7. Shkolla ka plan të shkruar bashkëpunimi me komunitetin që të nxisë dhe të organizojnë nxënësit që të angazhohen në aktivitetet e komunitetit dhe komunitetin në aktivitetet e shkollës.</p> <p>4.8. Shkolla ka dëshmi që mund të verifikohen se është e përfshirë në mënyrë aktive në jetën e komunitetit lokal, përmes zbatimit të projekteve të përbashkëta dhe pjesëmarrjes në ngjarjet me interes për komunitetin dhe shkollën.</p>
Kurrikula dhe procesi mësimor	<p>4.9. Mësimdhënësit/et në bashkëpunim me nxënësit, nxisin dhe përfshijnë në mënyrë aktive përfaqësues të komunitetit në realizimin e aktiviteteve kurrikulare dhe jashtëkurrikulare.</p> <p>4.10. Mësimdhënësit/et zhvillojnë konsultime me përfaqësues të komunitetit me rastin e hartimit të kurrikulës zgjedhore dhe i mbajnë dëshmitë me shkrim të përfshirjes apo mospërfshirjes të kërkesave të tyre.</p> <p>4.11. Mësimdhënësit i kanë në evidencë përmbajtjet kurrikulare që mund të pasurohen apo janë elaboruara me shembuj të veprimtarive të përbashkëta të shkollës me komunitetin, me qëllimin e rritjes së bashkëpunimit dhe përfitimeve të dyanshme.</p>

DIMENSIONI: BARAZIA GJINORE

Të gjitha vajzat dhe të gjithë djemtë kanë mundësi të barabarta për një pjesëmarrje të plotë në procesin mësimor që i adreson nevojat themelore dhe unike të vajzave dhe djemve; sigurohen materiale mësimore pa diskriminim gjinor dhe që mbështesin realizimin e të drejtave të njeriut.

Standardi 1

Vajzat dhe djemtë kanë mundësi të barabarta, trajtohen drejt në aspektin gjinor.

Menaxhimi dhe qeverisja	Treguesit 1.1. Shkolla respekton të gjitha aktet ligjore, kodin e etikës që kanë të bëjnë me mos diskriminimin gjinor, përfaqësimin e drejtë, respektimin e të drejtave dhe dinjitetit. 1.2. Shkolla ka kutinë për ankesa për të gjithë për paraqitjen e <i>çfarëdo dhune, presioni, ngacmimi seksual</i> , etj. 1.3. Shkolla ka komisionin për ankesa, i cili shqyrton ankesat sa i takon çështjeve të dhunës, presioneve, ngacmimeve, etj. Dhe ky komision raporton për këto ankesa para Këshillit drejtues të shkollës. 1.4. Shkolla ka program mësimor që rrit të kuptuarit dhe ndërgjegjësimin e mësimdhënësve dhe nxënësve rreth trajtimit me respekt sipas gjinisë.
Kapaciteti i shkollës	1.5. Shkolla ka personel profesional që merret me parandalimin dhe mbrojtjen e secilit <i>nga çfarëdo dhune, presioni, ngacmimi seksual</i> , etj. 1.6. Shkolla siguron pajisje/ <i>vegla</i> sportive që do të mundësojnë angazhimin e njëjtë të vajzave dhe djemve në aktivitete fizike dhe shfrytëzimin e barabartë të hapësirës për lojë dhe aktivitete të tjera. 1.7. Shkolla ka tualete dhe zhveshtore të ndara për vajza dhe djem, të cilat mund të përdoren në <i>çfarëdo</i> kohe dhe kanë qasje në artikuj higjienikë.
Kurrikula dhe procesi mësimor	1.8. Përmbajtjet programore ofrojnë njohuri se vajzat dhe djemtë, burrat dhe gratë kanë aftësi dhe potenciale të barabarta në të gjitha sferat. 1.9. Materialet mësimore (tekstet shkollore, doracakët, fletushkat, etj) janë të balancuar në aspektin gjinor dhe paraqesin përvoja nga këndvështrimi i të dy gjinive. 1.10. Angazhimi i vajzave dhe djemve është i drejtë në aktivitetet e ndryshme edukative, shoqërore dhe kulturore. 1.11. Të gjithë vajzat dhe djemtë marrin pjesë në mënyrë të barabartë në aktivitete në klasë dhe vlerësime. 1.12. Mësimdhënësit i trajtojnë barabar/drejt si djemtë dhe vajzat në procesin e vlerësimit.

Standardi 2 Vajzat dhe djemtë përgatiten përmes kurrikulës dhe procesit mësimor që të sillen në përputhje me konceptin e barazisë gjinore.	
Menaxhimi dhe qeverisja	Treguesit 3.1. Shkolla përmes rregulloreve të hartuara, përfitimet dhe privilegjet për personelin dhe nxënësit i trajton mbi bazën e aftësive dhe preferencave individuale dhe pa dallime gjinore.
Kapaciteti i shkollës	3.2. Personeli administrativ i shkollës ofron mundësi trajnimi për personelin e shkollës për çështje gjinore, për identifikimin e problemeve dhe se si të merren me dallimet gjinore. 3.3. Mësimdhënësit janë aftësuar përmes trajnimeve adekuate për ndërgjegjësimin gjinor, trajtimin e stereotipive gjinore dhe tejkalimin e tyre. 3.4. Mësimdhënësit janë trajnuar për identifikimin e formave të ndryshme të ngacimit seksual, të dhunës seksuale të dy gjinitë dhe si të reagojnë në situata të tilla. 3.5. Mësimdhënësit e lëndëve përkatëse janë trajnuar sa i përket shëndetit riprodhues, trajtimit të këtyre temave dhe tejkalimit të paragjyqimeve gjinore në këtë aspekt.
Kurrikula dhe procesi mësimor	3.6. Mësimdhënësit punojnë me nxënësit të identifikojnë dhe përmirësojnë paragjykimet gjinore në marrëdhëniet ndër personale. 3.7. Përmes detyrave që u japin, mësimdhënësit i mësojnë fëmijët të identifikojnë dhe përmirësojnë paragjykimet gjinore të prezantuara në tekstet shkollore, në pjesë të leximit dhe në materiale të tjera të mësimdhënies. 3.8. Të gjitha vajzat dhe djemtë janë aktiv dhe bashkëpunojnë në punë në grupe dhe çifte, si dhe trajtohen drejt gjatë prezantimit të punës. 3.9. Mësimdhënësit së bashku me fëmijët organizojnë aktivitete (si gara sportive, ngjarje kulturore, shfaqje, etj.) që ndihmojnë në krijimin e një kulture të përfshirjes dhe përfaqësimit të barabartë të vajzave dhe djemve në shkollë. 3.10. Djemtë dhe vajzat ndihmohen në mënyrë të barabartë në aspektin gjinor në aktivitete si brenda ashtu edhe jashtë klasës, shkollës, etj.

Standardi 3 Shkolla punon në arritjen e bilancit gjinor, veçmas në matematikë, shkencë dhe teknologji⁷	
Menaxhimi dhe qeverisja	<p>Treguesit</p> <p>3.1. Shkollat kanë formuar grupe të matematikanëve të rinj dhe të shkencëtarëve të rinj ku përfaqësohen drejt si vajzat dhe djemtë.</p> <p>3.2. Shkolla ka planin dhe organizon aktivitete në formë të garave me theks të veçantë për matematikë, shkenca dhe teknologji, ku vajzat dhe djemtë kanë qasje të barabartë.</p>
Kapaciteti i shkollës	<p>3.3. Shkolla siguron zhvillim profesional për mësime dhënësit për praktikat më të mira të mësime dhënies konceptuale të shkencës dhe matematikës, si dhe për mësime dhënien e shkencës duke përdorur metodat e pjesëmarrjes aktive të hulumtimit.</p> <p>3.4. Shkolla dhe mësime dhënësit i përkrahin në forma të ndryshme stimulimi (bursa, fonde për shkencëtarët e rinj, ndihmë profesionale, promovim, etj), edhe vajzat edhe djemtë që kanë talent (potenciale) për matematikë, shkenca dhe teknologji.</p> <p>3.5. Mësime dhënësit i mësojnë, aftësojnë dhe vlerësojnë si djemtë dhe vajzat në fushën e matematikës, shkencës dhe teknologjisë</p>
Kurrikula dhe procesi mësimor	<p>3.6. Përmbajtjet programore ofrojnë informata, njohuri dhe mundësi të barabarta për vajzat dhe djemtë në arritjen e shkathtësive, veçmas në matematikë, shkenca dhe teknologji.</p> <p>3.7. Mësime dhënësit u qasen njësoj si vajzave dhe djemve në përfaqësim dhe paraqitje në punën në grupe si në klasë dhe laboratorë të matematikës, shkencave dhe teknologjisë.</p>

⁷ Ky standard është kërkesë e kohës, duke qenë se gjithë shoqëritë po bëjnë përpjekje për shtimin e interesimit për shkenca, matematikë dhe teknologji të lartë. Kjo është edhe kërkesë e Kartës së Lisbonës për arsimin në Evropë. Gjithashtu, shoqëria e Kosovës në këto vitet e fundit shumë pak ka investuar në krijimin e kuadrove për matematikë, shkenca dhe teknologji të lartë. Prandaj, ky standard shihet si një diskriminim pozitiv që duhet të bëjë shoqëria jonë për të ecur me të arriturat në nivel evropian dhe botëror.

DIMENSIONI: DIVERSITETI KULTUROR

Shkolla u siguron të gjithë fëmijëve të drejtën themelore për arsim dhe mundësi të barabarta pa dallim të origjinës, identitetit kulturor, gjuhës, aftësive, apo rrethanave ekonomike, respektim të vlerave e shoqërisë, të bashkëjetesës në shoqëri, si dhe të qenit qytetar aktiv në botën e ndërvarur.

Standardi 1: Të gjithë fëmijët përgatiten të jetojnë në një shoqëri me ndryshime kulturore dhe ta respektojnë atë.

Menaxhimi dhe qeverisja	<p>Treguesit</p> <p>1.1 Shkolla ka planin zhvillimor që promovon të drejtën e çdo fëmije dhe familjes të jenë të përfshirë, të respektuar dhe vlerësuar në një shoqëri me diversitete kulturore.</p> <p>1.2 Shkolla ka strategji⁸ të bashkëpunimit me shkolla dhe partnerë të tjerë për të promovuar diversitetin kulturor, si binjakëzimi me shkolla, gara të diturisë, gara sportive, vizita në qytete me trashëgimi të pasur kulturore, etj.</p>
Kapaciteti i shkollës	<p>1.3 Shkolla dhe mësuesit trajtojnë çdo fëmijë me respekt, dinjitet dhe ofrojnë mundësi të barabarta për përfshirje në aktivitetet shkollore dhe jashtëshkollore.</p> <p>1.4 Shkolla në hapësirat e caktuara të saj ekspozon punime artistike të nxënësve të grupeve të ndryshme shoqërore, etnike, gjuhësore, etj.</p> <p>1.5 Mësuesit janë të aftësuar për të punuar me fëmijët që i përkasin diversiteteve të ndryshme kulturore dhe për të reaguar në situata, kur në shkollë paraqiten paragjykimet për kulturat tjera.</p>
Kurrikula dhe procesi mësimor	<p>1.6 Kurrikula ofron përmbajtje programore dhe modele të respektimit të kulturave, traditave, besimeve, gjuhëve të ndryshme etj.</p> <p>1.7 Mësuesit u ofrojnë nxënësve materiale didaktike që pasqyrojnë në mënyrë të drejtë diversitetet kulturore dhe rëndësinë e diversiteteve në shoqëri.</p> <p>1.8 Mësuesit i mësojnë fëmijët që të njohin dhe përmirësojnë imazhet negative të pjesëtarëve të grupeve të ndryshme kulturore, të cilat paraqiten në tekste shkollore dhe materiale të ndryshme të mësimdhënies.</p>

⁸ Me këtë kontekst strategjia përfshin një metodologji të definuar që çon drejt një qëllimi të caktuar, duke përfshirë planet dhe programet, aktivitetet shkollore dhe të gjitha dokumentet e tjera të shkollës.

Standardi 2 Të gjithë fëmijët i kuptojnë vlerat e shoqërisë, të bashkëjetesës në shoqëri, si dhe të qenit qytetar aktiv në botën e ndërvarur.	
Menaxhimi dhe qeverisja	Treguesit 2.1 Shkolla ka rregullore të bazuar në ligjet ekzistuese për respektimin e të drejtave të fëmijës dhe të njeriut. 2.2 Shkolla ka procedura dhe i zbaton ato për përfshirjen e mësimdhënësve, nxënësve, prindërve dhe komunitetit, në aktivitete për informim dhe promovim të diversitetit kulturor, integrimin e grupeve shoqërore, etj.
Kapaciteti i shkollës	2.3 Shkolla organizon punë shtesë për motivimin e të gjithë fëmijëve si dhe integrimin e fëmijëve në nevoja në arsim si janë: fëmijët e kthyer nga diaspora, fëmijët me nevoja të veçanta, fëmijët që lëvizin nga një vend në një tjetër, etj. 2.4 Shkolla ofron mundësi trajnimi për mësimdhënës që ata të jenë të përgatitur për të lehtësuar të mësuarit për çdo nxënës individualisht, pa marrë parasysh se sa të ngjashëm apo të ndryshëm janë.
Kurrikula dhe procesi mësimor	2.5 Mësimdhënësit e përshtatin mjedisin e punës dhe aktivitetet e të mësuarit, ashtu që fëmijët me diversitete të ndryshme kulturore, me nevoja të ndryshme në arsim dhe të niveleve të ndryshme shoqërore të jenë pjesëmarrës të barabartë. 2.6 Kurrikula shkollore ofron përmbajtje programore për respektimin e të drejtave të njeriut, të fëmijës dhe të qenit qytetar aktiv. 2.7 Mësimdhënësit i ndihmojnë fëmijët të organizojnë aktivitete që të kuptojnë, të pranojnë dhe vlerësojnë diversitetin (ndryshimet). 2.8 Mësimdhënësit përgatisin nxënësit që të <i>“mendojnë globalisht dhe të veprojnë në nivel vendor”</i> (njohuritë e përgjithshme, gjithëpërfshirëse t’i përshtaten kontekstit vendor për të qenë reale, specifike dhe të zbatueshme për vendin tonë). 2.9 Mësimdhënësit organizojnë aktivitete rreth njohjes (ngjashmërive dhe dallimeve) të historisë dhe kulturave të popujve tjerë, të vendeve tjera dhe ndërlidhjen e njerëzve dhe kombeve. 2.10 Mësimdhënësit punojnë me fëmijët që të trajtojnë të tjerët me drejtësi, me paanësi, respekt dhe dinjitet dhe të presin që edhe të tjerët të sillen në mënyrë të njëjtë.

3.8. Si mund të shfrytëzohen standardet dhe treguesit për të vetëvlerësuar performancën e punës së shkollës?

Njëri prej qëllimeve të përdorimit të Standardeve të Shkollave Mike për Fëmijë është shfrytëzimi i tyre si instrumente për vetëvlerësim të performancës së shkollës. Kjo nënkupton se secila shkollë duhet të bëjë një analizë të detajuar në bazë të këtyre standardeve në një periudhë të caktuar kohore, me qëllim që ta kuptojë me kohë se cilat janë përparësitë e saj, të cilat duhet të mbahen edhe më tutje dhe të përforcohen, si dhe cilat janë aspektet të cilat duhet t'i përmirësojë në kontinuitet të punës.

Vlerësimi i brendshëm (vetëvlerësimi) në shkollë duhet të bëhet çdo vit, përkatësisht duhet të bëhet pas realizimit të një cikli të aktiviteteve të ndërmarra për ndryshime në nivel shkollë, që të konstatohen rezultatet e arritura pas aktiviteteve të ndërmarra për mënjanimin e mangësive në shkollë dhe përparimin e saj në segmente të përcaktuar në planet e veprimit.

Vlerësimi i brendshëm (vetëvlerësimi) në shkollë konkretizohet me instrumentin e vlerësimit, i cili përbëhet/ndërtohet nga treguesit e Standardeve të Shkollave Mike për Fëmijë dhe nga shkallët e vlerësimit që duhet dhënë për çdo tregues. Shkallët e vlerësimit shpërbejnë për të vlerësuar gjendjen aktuale në shkollë. Lidhur me vlerësimin e brendshëm (vetëvlerësimin) e shkollës në bazë të standardeve dhe treguesve të Shkollave Mike për Fëmijë janë përcaktuar shkallët e vlerësimit në vijim:

0 = i paplotësuar fare, d.m.th. kërkesat e formuluar në treguesin përkatës nuk janë arritur fare në shkollë;

1 = i plotësuar në masë të pamjaftueshme, d.m.th. ka vetëm një apo dy të dhëna të sakta se kërkesat e formuluar në treguesin përkatës janë arritur në shkollë;

2 = i plotësuar pjesërisht, d.m.th. ka disa të dhëna se kërkesat e formuluar në treguesin përkatës janë arritur në shkollë, mirëpo kërkesat janë duke u përfillur pjesërisht;


3 = i plotësuar mjaftueshëm, d.m.th. kërkesat e formuluar në treguesin përkatës janë arritur dhe janë duke u përfillur në masë mjaft të madhe në shkollë; dhe

4 = i plotësuar në nivel të lartë, d.m.th. kërkesat e formuluar në treguesin përkatës janë arritur dhe janë duke u përfillur në mënyrë të plotë në shkollë.

Shkolla (ekipi shkollor) mund të fillojë të bëjë vetëvlerësimin vetëm për një dimension, për shembull në Dimensionin: *Efektiviteti në mësimdhënie dhe nxënie*. Mirëpo, nisur nga fakti se Standardet e Shkollave Mike për Fëmijë po aplikohen për herë të parë në Kosovë preferohet që vetëvlerësimi i parë i performancës së shkollës duke u bazuar në këto standarde të jetë një vlerësim i gjithmbarshëm, kurse në fazat tjera mund të bëhet i pjesëshëm, varësisht nga specifikat dhe kapacitetet e shkollës, por duhet të bëhet çdo vit.

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtyre standardeve, **MASHT dhe IPK**, në bashkëpunim me partnerët që mbështesin zhvillimin e arsimit në Kosovë, **do të ofrojnë udhëzues**

praktikë dhe përkrahje shkollave në ngritje të kapaciteteve për zbatimin e standardeve në praktike. Mirëpo, konsiderojmë se shkollat që janë të interesuara të fillojnë me vlerësim të brendshëm (vetëvlerësim) të performancës së shkollës, me qëllim të përmirësimit dhe avancimit të saj dhe kanë kapacitete të zhvilluara për të ndërmarrë aktivitetet për arritjen e këtij qëllimi, këtë mund ta bëjnë duke ndjekur hapat në vijim:



BIBLOGRAFIA

1. Anne Katz, Ph.D., Lynn Evans, Ph.D., Katherine Ramage, Ph.D. (2011). Efektiviteti i mësimdhënies dhe nxënies dhe shkollat mike për fëmijë, Miske Witt & Associates.
2. Christopher Johnstone, Ph.D. (2011). Arsimi gjithëpërfshirës dhe shkollat mike për fëmijë, Miske Witt & Associates.
3. Clair, N. (2011). Elemente të shkollave mike për fëmijë në Maqedoni. [Shënimet e pabotuara nga takimi rajonal UNICEF BShP/EQL, Shkup, Maqedoni]. Miske Witt & Associates.
4. Elisabeth Backman dhe Bernard Trafford.(2007). Qeverisja demokratike e shkollave, Këshilli Evropian, Strasburg.
5. Grillo, prof. dr. Kozma (2002). *Fjalori i edukimit* (Psikologjia - Sociologjia – Pedagogjia), “Drita 2000”, Prishtinë.
6. Grup autorësh. (2005). Përmirësimi i performancës së organizatës, ADEA, Prishtinë.
7. Grup autorësh. (2008). Zhvillimi i arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë (sfidat dhe rezultatet), Prishtinë.
8. Grup autorësh. (2011). Kërkime pedagogjike 2, Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë.
9. Hyseni, H., Salihaj, J., Nikoleta, M., Pupovci, D., (2003). Qeverisja dhe menaxhimi në arsim, QAK, Prishtinë.
10. Hyseni. Halim. (2009). Raport nga hulumtimi i shpejtë i vlerësimit të gjendjes së të drejtave të fëmijës si dhe të gjendjes së sigurisë në shkollat e Kosovës, KEC & UNICEF, Prishtinë.
11. Jasmina Josic, Ph.D., Katherine Ramage, Ph.D. (2011). Shëndeti, siguria dhe mbrojtja, Miske Witt & Associates.
12. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë & BEP/USAID. (2011). Standardet e praktikës profesionale për drejtorët e shkollave-draft. Prishtinë.
13. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2009). Strategjia për shkollat promovuese të shëndetit në Kosovë 2009-2018, Prishtinë.
14. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2010). Plani Strategjik Arsimit në Kosovë 2011-2016, Prishtinë.
15. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2010). Plani strategjik për organizimin e arsimit gjithëpërfshirës të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në arsimin parauniversitar në Kosovë 2010-2015, Prishtinë.
16. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2010). Udhëzimi administrativ mbi Licencimin e Mësimdhënësve, Prishtinë.
17. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2011). Korniza e Kurrikulit e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, Prishtinë.
18. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2011). Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032. Prishtinë.
19. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë dhe SWAP. (2011). Profili i kompetencave të mësimdhënësve, Prishtinë.

20. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, (2007). Strategjia për integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë 2007-2017. Prishtinë.
21. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, (2011). Udhëzuesi i etikës për vlerësimin e nxënësit, Nr. 491 / 01B, 23.12.2011. Prishtinë.
22. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2007). Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar në Kosovë 2007-2017. Prishtinë.
23. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2008). Ligji për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068 (2008). Prishtinë.
24. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2010). Kriteret dhe procedurat për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve. Prishtinë.
25. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2010). Udhëzimi administrativ: Krijimi dhe fuqizimi i ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar, Prishtinë.
26. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2011). Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme 0-6 vjet, Prishtinë.
27. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2011). Udhëzuesi për standardet e vlerësimit, Nr. 490 / 01B, 23.12.2011. Prishtinë.
28. Ministrisë së Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, (2011). Raport për punëtorinë - Zhvillimi i Standardeve për Shkollat Mike për Fëmijë (Raport i papublikuar) Prishtinë.
29. Miske, S. J. (2008). *Zhvillimi i shkollave mike për fëmijë në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë: Një studim rasti*. Shkup, Maqedoni: UNICEF.
30. Mohammed Elmeski, M.A. (2011). Pjesëmarrja demokratike dhe shkollat mike për fëmijë, Miske Witt & Associates.
31. Naker, D. (2007). What is a good school? Imagining beyond the limits of today to create a better tomorrow. Raising voices with support from The Ford Foundation.
32. Raya Hegeman-Davis, M.A. (2011). Përshtatshmëria gjinore dhe shkollat mike për fëmijë, Miske Witt & Associates.
33. Riddell, A. (2008). Factors influencing educational quality and effectiveness in developing countries: A review of research. Published by GTZ.
34. Tony Booth dhe Denise Kingston, (2009). Udhëzuesi për përfshirje në institucionet parashkollore (version i përkthyer në gjuhën shqipe), Prishtinë.
35. UNESCO. (2008). "Barazia dhe gjithëpërfshirja në arsim – Mjetet për mbështetjen e sektorit të arsimit, planifikimit dhe vlerësimit".
36. UNICEF. (1989). Konventa mbi të drejtat e fëmijës. Marrë nga <http://www.unicef.org/crc/>
37. Zyra e Komisionarit të Lartë të OKB për të Drejtat e Njeriut: Konventa mbi të drejtat e fëmijës: <http://www2.ohchr.org/english/law/crc.htm>

Në hartimin e standardeve morën pjesë:

Ekipi drejtues:

Hajrije Devetaku-Gojani, hulumtuese për standarde dhe vlerësim në Institutin Pedagogjik të Kosovës

Selim Mehmeti, hulumtues për standarde dhe vlerësim në Institutin Pedagogjik të Kosovës

Grupi punues:

Drita Haxhaj, Sektori i inspektimit të arsimit në Pejë

Fatmir Elezi, Sektori i vlerësimeve dhe standardeve - MASHT

Hajrije Balidemaj, mësimdhënëse në SHMU “ Naim Frashëri”, në Prishtinë

Igballe Cakaj, udhëheqëse e Sektorit të trajnimeve - MASHT

Isuf Gashi, Sektori i infrastrukturës - MASHT

Labëri Luzha, udhëheqëse e Sektorit të edukimit parashkollor - MASHT

Leonora Shala, Sektori për shkollat e shëndetshme - MASHT

Mevlude Aliu, hulumtuese në Institutin Pedagogjik

Miranda Kasneci, zv.udhëheqëse e Departamentit për zhvillimin e arsimit parauniversitar - MASHT

Nezir Çoçaj, drejtor i Institutit Pedagogjik

Sahare Reçica, hulumtuese në Institutin Pedagogjik

Shqipe Gashi, Sektori i planeve dhe programeve në MASHT

Vjollca Ymerhalili, Sektori i vlerësimeve dhe standardeve - MASHT

Konsulentët ndërkombëtarë:

Anne Katz & Katherine Ramange - Miske Witt & Associates Inc,

Violeta Petroska – Beshka, Centar for Human Rights and Conflict Resolution

Konsulent vendor:

Afërdita Spahiu, eksperte e edukimit – Zyra e UNICEF-it për Kosovë

Përveç anëtarëve të grupit punues, në hartimin e dokumentit të standardeve kanë kontribuar, përmes seminareve, diskutimeve dhe punëtorive rajonale, edhe mësimdhënës, drejtorë të institucioneve shkollore, prindër, përfaqësues të arsimit në komuna, inspektorë të sektorit të arsimit, zyrtarë dhe ekspertë të arsimit. Instituti Pedagogjik i Kosovës falënderon të gjithë që kontribuan në hartimin e këtij dokumenti me rëndësi të veçantë për arsimin parauniversitar në Kosovë.

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

ISBN